

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7341 E enjte 2 Nëntor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **Ditës**

Kohë më parë, i ndodhur në një grup njerëzish që kishin për mision të kontrollonim infrastrukturën shkollore, mbarëvajtjen e ndërtesave ...

Vijon në faqen 20

Nga ANDON ANDONI

Shkolla, kisha dhe xhamia



Opinion **Ditës**

Nga JORIDA TABAKU

E gjithë vëmendja e publikut, jo më kot, sot është fokusuar në debatin mbi vlefshmërinë dhe logjikën ekonomike dhe kushtetuese të Buxhetit të Shtetit. ...

Vijon në faqen 21

"Buxheti 2018", 48 milionë euro taksa shtesë për qytetarët e bizneset



Emrat e trashëgimtarëve që marrin dëmshpërblim

Ish-të dënuarit, lista e tretë me përfituesit e kështit të I e të II

Lista me dokumentet që duhet të plotësojë gjithsecili për të marrë paratë

Nga ORNELA MANJANI

Ministria e Financave ka publikuar listën e kategorisë joparësore në radhët e ish-të përndjekurve politikë që mund të trajtohen me dëmshpërblim, por që sipas këtij dikasteri duhet të sjellin dokumentet ...

Në faqen 14-15

RAMA EMERON KOLONELIN E PARE GRUA, MBROJTI PAKTIN DETAR ME GREQINE

12 USHTARAKET QE EMEROHEN PREFEKTE

Kush janë të përzgjedhurit e rinj. "Kapiteni" i Durrësit, i dënuar me gjobë nga ILDKP. Arsyet e lëvizjeve, betejë e hapur kundër kultivimit të kanabisit



(Në foto) Kryeministri Edi Rama gjatë prezantimit të 12 prefekteve

BASHA: SHTETI KRIMI

"Habilajt", dosja e përthyer me 1800 faqe i jepet prokurorisë

Në faqen 4-5

ZGJEDHJET 2017

KQZ: Partitë shpenzuan 250 milionë lekë, PS renditet në krye

Në faqen 6

PROGRAMET

Bursa studimi në SHBA, kriteret që ju japin kualifikimin

Në faqen 12

1 MLN EURO GRANTE

Meta, takim 30 minuta me Vlahutin: Çelja e negociatave, vitin që vjen

Në faqen 2

SI NDOHDI NGJARJA



Sulmi terrorist në SHBA, Trump: Do t'i japim fund Lotarisë Amerikane

Në faqen 13

Zbardhen debatet në Komisionin e Ekonomisë, opozita çon në Kushtetuese vendimin

Veliaj: Taksim progresiv për pronën

"Ndryshimi i formulës do të sjellë 3 milionë të ardhura në vit"

Nga ORNELA MANJANI

Bashkia e Tiranës do t'i propozojë Kuvendit ndryshimin e taksës së pronës për biznesin, duke aplikuar taksimin progresiv. Lajmi u bë me dije nga kryebashkiaku, Erion Veliaj, gjatë Këshillit Konsultativ të Qeverisjes



Qendrore me atë Vendore, duke theksuar se kjo taksë duhet të jetë 0.25% e vlerës së pronës. Gjithashtu, Veliaj tha se janë të domosdoshme ndryshime në buxhet, duke shërbimin zjarrfikës, duke kërkuar që transferta të bëhet në bazë të emergjencave....

Në faqen 8-9

SITUATA POLITIKE

TAKIMI

Presidenti pret ambasadorin e BE, diskutojnë për situatën

Darina Tanushi

Meta, takim 30-minutësh me Vlahutin: Çelja e negociatave, vitin që vjen

Grant për bashkitë, BE 1.1 mln euro për shoqërinë civile

Presidenti i Republikës, Ilir Meta, priti dje në një takim kreun e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, ambasadorin Romana Vlahutin. Biseda mes tyre ka zgjatur gati 30 minuta. Sipas një njoftimi të shkurtër të Presidencës, kreu i shtetit, Meta diskutoi për mundësinë e çeljes së negociatave brenda vitit të ardhshëm, si një hap shumë të rëndësishëm për Shqipërinë dhe të ardhmen e saj. Presidenti Meta nënvizoi domosdoshmërinë e vazhimit të reformave kyçe, veçanërisht zbatimin e reformës në drejtësi si edhe forcimin e sundimit të ligjit, me fokus luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Në fakt, takimi Meta-Vlahutin vjen në një moment kur është ende i freskët largimi i kreut të SHISH-it, Visho Ajazi Likaj, i cili dje u dekretua nga Meta, por edhe dosja e hapur për ish-ministrin Tahiri. Nuk dihet në fakt se çfarë është diskutuar për këto dy çështje mes dy bashkëbiseduesve.

Marrëveshja me bashkitë Ndërkohë më herët, ambasadorja e BE-së ishte dje në një takim mes 12 bashkive të vendit dhe PNUD-it, ku u nënshkrua edhe një marrëveshje. Programi Rajonal për Demokraci Vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD) i financuar nga BE-ja nisi dje, pikërisht me nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit mes 12 bashkive shqiptare me partner zbatues PNUD Albania. Rreth 100 organizata të shoqërisë civile do të përfitojnë nga një skemë granti prej 1.2 milionë euro për Shqipërinë. Projektet e financuara do të ndihmojnë për zbatimin e strategjive vendore të zhvillimit që përmirësojnë cilësinë e jetës për qytetarët, të cilët jetojnë në këto bashki dhe nxisin pjesëmarrjen dhe llogaridhënien. "Kjo do të ketë një ndikim të vërtetë mbi jetët e njerëzve, nëpërmjet organizatave të shoqërisë civile, që punojnë së bashku me bashkitë për të siguruar shërbime më të mira, si dhe më të shënjestruara dhe më përfshirëse për qytetarët", tha ambasadorja e BE-së, Romana Vlahutin, gjatë ceremonisë. Vlahutin u shpreh se granti i BE-së për këtë projekt është 8.5 milionë euro dhe synohet rritja e shërbimit dhe transparencës ndaj qytetarëve. "Ju jeni institucionet me afër qytetaze çdo ditë dhe kjo vlen më shumë




Presidenti i Republikës, Ilir Meta, gjatë takimit të djeshëm me ambasadorin Romana Vlahutin

për reformën administrative. 8.5 mln euro është granti i BE për këtë projekt. Patëm një vizitë në Dibër dhe sa herë shkojmë në bashki, bëhemi entuziastë për atë që mund të arrihet. Programi ka të bëjë me forcimin e kapaciteteve.

Mungesa e transparencës është pengesë për ecurinë. Ka organizata që nuk kanë kapacitete për të thithur grante. T'u japim shërbime më të mira qytetarëve. Shqipëria është vend kandidat për në BE dhe duhen pasur parasy-

ROMANA VLAHUTIN
"Programi ka të bëjë me forcimin e kapaciteteve. Mungesa e transparencës është pengesë për ecurinë. Ka organizata, që nuk kanë kapacitete për të thithur grante. T'u japim shërbime më të mira qytetarëve. Shqipëria është vend kandidat për në BE dhe duhen pasur parasysh rekomandime e KiE", tha dje shefja e BE-së.

sh rekomandime e KiE. Mendojmë një program i tillë do të jetë një tullë e rëndësishme e fuqizimit të shoqërisë civile", - tha Vlahutin gjatë fjalës së saj. Ndër të tjera, Vlahutin tha se për këtë projekt konkurruan 35 bashki, por u përzgjedhën vetëm 12. "12 bashki do kenë mbështetje nga BE për të mbështetur demokracinë lokale dhe shoqërinë civile. 35 bashki konkurruan për projektin dhe 12 prej tyre u përzgjedhën", - tha Vlahutin.



Kryeministri Edi Rama dhe gjatë prezantimit të 12 prefekteve të qarqeve



VISHO AJAZI LIKA

Presidenti Ilir Meta ka dekretuar dje lirin nga detyra të drejtorit të Shërbimit Informativ të Shtetit, Visho Ajazi Lika. Të hënën kryeministri Rama në një takim i paraqiti Presidentit Meta dorëheqjen e Visho Ajazi Likës dhe propozimin për emërim në vend të tij të Helidon Bendos.

Dekretimi

Sekretari i Përgjithshëm: Procesi shtyhet deri më 30 nëntor

Balla mbledh 61 krerët e PS-së, zgjedhje në 16 degë, kryetarët që ikin

61 kryetarë të PS-së në bashkitë e vendit raportuan dje para sekretarit të përgjithshëm të PS-së, Taulant Balla, në një takim në selinë rozë. Për më shumë se një orë, Balla ka dëgjuar ecurinë e procesit zgjedhor nëpër degë. Procesi zgjedhor pritet të përfundojë në 30 nëntor, edhe pse ishte parashikuar që ai të mbaronte më datë 15 nëntor. Janë 16 bashki që do duhet të rizgjedhin kryetarët e tyre, pasi kryetarët aktualë do duhet të lenë detyrën për rezultate të dobëta në detyrë. Gjithashtu, janë edhe dhjetë kryetarë bashkie që ushtrojnë paralelisht detyrën e kryetarit të degës, por edhe funksione të tjera. Mes tyre janë kryetarët e



Sekretari i përgjithshëm i PS-së, Taulant Balla

PS në Shkodër (Arvit Osja), Gjirokastrë (Flamur Golemi), Berat (Valbona Zylyftari), Lushnje (Lindita Buxhehi), Lezhë (Ardiana Jaku). Pasi ka dëgjuar 61 krerët e

degëve të PS, sekretari i përgjithshëm, Taulant Balla, ka urdhëruar shtyrjen me 15 ditë të procesit zgjedhor. Kështu, procesi zgjedhor në degët e PS do të jetë

KRYEBASHKIAKËT E PS QË IKIN:

- Kamëz - Ramadan Cani
- Kavajë - Gentian Daja
- Rrogozhinë - Haxhi Memolla
- Peqin - Edurim Teqja
- Cërrik - Gëzim Salla
- Elbasan - Ardit Demiri
- Përrenjas - Haxhi Çollaku
- Pogradec - Bledi Çomo
- Pustec - Jani Ago
- Devoll - Eroidi Begolli
- Dibër - Afrim Mikli
- Vau i Dejës-Kristian Shkreli
- Kuçovë - Sybi Shehu
- Skrapar - Edmond Omeri
- Këlcyrë - Hodjan Selami
- Shkodër - Arvit Osja

deri më 30 nëntor. "Kishim mbledhje organizative, që lidhet me raportimin e procesit zgjedhor në të gjitha degët. Kemi shtyrë afatin e procesit zgjedhor me 15 ditë për të përmbyshur sipas statutit, të gjitha kërkesat që lidhen me kryetarët e organizatave", tha Balla. Në përfundim të mbledhjes me krerët e 61 degëve, nënkryetarja e grupit të PS, Elisa Spiropali, tha se po bëhet

analiza në bazë të rezultateve të 2013 për rizgjedhjeve, moskandidimin apo edhe njëherë konfirmimin e atyre që kanë pasur rezultate të mira. "Ne kemi nxjerrë një udhëzim, që ka qenë edhe publik, po bëhet analiza në bazë të rezultateve që kanë pasur në 2013 për rizgjedhje, moskandidim apo edhe njëherë konfirmim, atëherë kur kanë pasur rezultate të mira", tha Spiropali.



Kolonelja e parë që mbrojti paktin detar, në krye të Prefekturës së Tiranës

Rama shkarkon 12 prefektët, i zëvendëson me 12 ushtarakë

"Kapiteni" i Durrësit, i dënuar me gjobë nga ILDKP

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama ndryshoi dje 12 prefektët e qarqeve, duke emëruar në këto pozicione 12 ushtarakë. Vendimi ka qenë i papritur dhe është bërë publik nga vetë kryeministri Edi Rama, në një dalje për mediat së bashku me 12 prefektët e rinj. "Kemi ndër-tuar një proces për rreth 40 ditë dhe në mënyrë aktive, por edhe skrupuloze kemi vlerësuar, pasi kemi rënë dakord mes vedit për profilin e ri të prefektit, një numër kandidatash nga radhët e ushtarakëve të lartë, që nuk janë më pjesë aktive e Forcave të Armatosura, por që janë bërë të një ekspertencës të çmuar që ky vend nuk ka luksin të mos e përdorë në funksion të së ardhmes së tij", u shpreh Rama. Kryeministri foli për një institucion të Prefektit të ridimensionuar tërësisht, si një institucion përfaqësues i kryeministrit dhe i qeverisë në çdo qark.

"Nëse do të kthejmë kokën pas, ky është një institucion që mbeti në hije, në një pozicion letargjik dhe ndërkohë, dinamika e re e kësaj faze të re qeverisëse, si dhe pritshmëritë e larta që njerëzit kanë nga kjo fazë qeverisëse kërkojnë një qasje dhe një profil të ri të figurës së prefektit", tha Rama. Duke folur për kriteret mbi të cilat ishin përzgjedhur të 12 ushtarakët që morën detyrën e prefektit në 12 qarqet e vendit, Rama vuri në dukje se kjo bëhet për të arritur objektivat e vendosur për një luftë kundër korrupsionit e po kështu edhe në kuadër të "betejës së hapur kundër kultivimit të kanabisit, për t'i shkuar nga pas dhe për t'i vënë prapa hekurave rrjetat dhe elementët kriminalë, si dhe për të rimarrë për publikun asetet e tyre, të përfutuara nga veprimtaria kriminale". "Nga prefektët e rinj kërkohet edhe një transformim rrënjësor i vetë institucioneve të prefekturave, ku ata do të hyjnë duke filluar nga dita e nesërme, për të vendosur në kontroll të plotë, rigoroz dhe efektive në të gjithë fushën e tyre të përgjegjësisë, por edhe një kullë vrojtimi për të gjithë veprimtarinë shtetërore në territor", tha Rama.

PREZANTIMI

Kreu i qeverisë i prezantoi me radhë emrat e rinj të prefektëve që vijnë nga ush-



Kryeministri Edi Rama

KRYEMADHI

"Kemi një qeveri që po shikojmë teatër, se si emërohen apo çemërohen drejtorët apo prefektët dhe sigurisht që shikojmë edhe prova gjeneralë, apo teatrin e radhës nëpër televizione, të cilat nuk janë gjë tjetër veçse kazani i oligarkëve, të cilët i përgatisin z. Rama apo kryeministrit Lolo të ardhmen e tij qeverisëse", tha dje Kryemadhi.

nga 2 ministrat e Jashtëm të kohës, Lulzim Basha dhe Dora Bakojanis. Kushtetuesja veprimi pas padisë që depozituan aty Saimir Tahiri dhe Ervin Bushati në emër të Partisë Socialiste. "GSH.al" ka ripublikuar sot letrën që kolonela Suzana Jahollari i dërgon Myslim Pashajt, në republikë të studimit të tij prej 117 faqesh, ku argumentohet se ky pakt nuk duhet ratifikuar në Kuvend, pasi ishte në dis-favor të Shqipërisë. Ndërkohë, prefekti i ri i Durrësit do të jetë Roland Nasto. Kryeministri Edi Rama e paraqiti Naston, si "Kapitenin" i rangut të parë të Forcave Detare në rezervë, komandant i Republikës së Shqipërisë në Itali.

1. **ROLAND NASTO** emërohet prefekt i qarkut të Durrësit, kapiten i rangut të parë të Forcave Detare në rezervë.
 2. **ÇESK MILLJA** emërohet prefekt i qarkut të Shkodrës, kolonel në rezervë, pedagog në Akademinë Ushtarake.
 3. **BAKI BALA** emërohet prefekt i qarkut të Fierit, kolonel në rezervë, drejtor i Drejtorisë së Modernizimit në Ministrinë e Mbrojtjes, drejtor i Drejtorisë së Ndërlidhjes me Shtabin e Përgjithshëm.
 4. **DHORI SPIOULLARI** emërohet prefekt i qarkut të Korçës, gjeneral brigade në rezervë, drejtor i Drejtorisë së Personelit në Shtabin e Përgjithshëm, komandant i Forcës Ajrore të Republikës së Shqipërisë.
 5. **MARILLA DAFI** emërohet prefekt i qarkut të Beratit, kapiten i rangut të parë të Forcave Detare në rezervë, komandant i Distriktit Detar, drejtor i kanteitit të ndërtimit të anijeve në Vlorë.
 6. **NEXHEDIN SHEHU** emërohet prefekt i qarkut të Dibrës, kolonel në rezervë.
 7. **ASTRIT ALIAJ** emërohet prefekt i qarkut të Gjirokastrës, kapiteni i rangut të parë të Forcave Detare në rezervë, komandant i Akademiës së Forcave Detare, atashu ushtarak i Republikës së Shqipërisë në Itali.
 8. **SUZANA JAHOLLARI** emërohet prefekt i qarkut të Tiranës, e para kolonelle në historinë e Forcave të Armatosura, kolonelle në rezervë. Zonja Suzana Jahollari, komandante e Akademiës së Nënoficerëve Tomson, drejtoreshë e Drejtorisë së Inspektimit në Ministrinë e Mbrojtjes.
 9. **MAKSIM MALAJ** emërohet prefekt i qarkut të Elbasanit, gjeneral major në rezervë, komandant i Brigadës së Reagimit të Shpejtë, shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.
 10. **ZENEL KUÇANA** emërohet prefekt i qarkut të Kukësit, kolonel në rezervë që përballoi luftën e Kosovës.
 11. **GJERGJ PRENDI** emërohet prefekt i qarkut të Lezhës, major në rezervë.
 12. **FLAMUR MAMAJ** emërohet prefekt i qarkut të Vlorë, me arsim ushtarak dhe civil në nivelin universitar.

PREFEKTËT E EMËRUAR

1. **ROLAND NASTO** emërohet prefekt i qarkut të Durrësit, kapiten i rangut të parë të Forcave Detare në rezervë.
2. **ÇESK MILLJA** emërohet prefekt i qarkut të Shkodrës, kolonel në rezervë, pedagog në Akademinë Ushtarake.
3. **BAKI BALA** emërohet prefekt i qarkut të Fierit, kolonel në rezervë, drejtor i Drejtorisë së Modernizimit në Ministrinë e Mbrojtjes, drejtor i Drejtorisë së Ndërlidhjes me Shtabin e Përgjithshëm.
4. **DHORI SPIOULLARI** emërohet prefekt i qarkut të Korçës, gjeneral brigade në rezervë, drejtor i Drejtorisë së Personelit në Shtabin e Përgjithshëm, komandant i Forcës Ajrore të Republikës së Shqipërisë.
5. **MARILLA DAFI** emërohet prefekt i qarkut të Beratit, kapiten i rangut të parë të Forcave Detare në rezervë, komandant i Distriktit Detar, drejtor i kanteitit të ndërtimit të anijeve në Vlorë.
6. **NEXHEDIN SHEHU** emërohet prefekt i qarkut të Dibrës, kolonel në rezervë.
7. **ASTRIT ALIAJ** emërohet prefekt i qarkut të Gjirokastrës, kapiteni i rangut të parë të Forcave Detare në rezervë, komandant i Akademiës së Forcave Detare, atashu ushtarak i Republikës së Shqipërisë në Itali.
8. **SUZANA JAHOLLARI** emërohet prefekt i qarkut të Tiranës, e para kolonelle në historinë e Forcave të Armatosura, kolonelle në rezervë. Zonja Suzana Jahollari, komandante e Akademiës së Nënoficerëve Tomson, drejtoreshë e Drejtorisë së Inspektimit në Ministrinë e Mbrojtjes.
9. **MAKSIM MALAJ** emërohet prefekt i qarkut të Elbasanit, gjeneral major në rezervë, komandant i Brigadës së Reagimit të Shpejtë, shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.
10. **ZENEL KUÇANA** emërohet prefekt i qarkut të Kukësit, kolonel në rezervë që përballoi luftën e Kosovës.
11. **GJERGJ PRENDI** emërohet prefekt i qarkut të Lezhës, major në rezervë.
12. **FLAMUR MAMAJ** emërohet prefekt i qarkut të Vlorë, me arsim ushtarak dhe civil në nivelin universitar.

PREFEKTËT E SHKARKUAR

1. Emilian Jani, prefekt i qarkut të Durrësit.
2. Paulin Radovani, prefekt i qarkut të Shkodrës.
3. Vasil Bregu, prefekt i qarkut të Fierit.
4. Pandi Papandou, prefekt i qarkut të Korçës.
5. Valbona Zylyftari, prefekte e qarkut të Beratit.
6. Ardit Kaja, prefekt i qarkut të Dibrës.
7. Flamur Bime, prefekt i qarkut të Gjirokastrës.
8. Admir Ajbrija, prefekt i qarkut të Tiranës.
9. Ardit Demiri, prefekt i qarkut të Elbasanit.
10. Liman Morina, prefekt i qarkut të Kukësit.
11. Eduard Ndreca, prefekt i qarkut të Lezhës.
12. Etjona Hoxha, prefekt i qarkut të Vlorës.

tria, ku veçohet e vetmja grua, prefekta e re e Tiranës, e cila është e para kolonelle në historinë e Forcave të Armatosura, kolonelle në rezervë, Suzana Jahollari. Ajo është komandante e Akademiës së Nënoficerëve Tomson, drejtoreshë e Drejtorisë së Inspektimit në Ministrinë e Mbrojtjes, me kualifikime në Holandë dhe SHBA, e aktivizuar në forume të NATO-s, që lidhen me

barazinë gjinore dhe çështje të tjera. Vite më parë, në kulmin e debatit për nënshkrimin e marrëveshjes së kufijve detarë me Greqinë të qeverisë "Berisha", ajo ka mbrojtur këtë marrëveshje duke e quajtur në zbatim të konventave të OKB-së. Ndërkohë që për herë të parë në historinë e saj, Gjykata Kushtetuese e rrëzoi paktin detar me Greqinë të firmosur

LULZIM BASHA

"Llustraxhiu doli sot me 12 shërbëtorë të rinj, në një përpjekje të dëshpëruar për ta çuar vëmendjen diku tjetër, i zënë siç është nga skandali i madh i narko-shtetit. Po ç'lidhje kanë ca të emëruar, që as nuk do të marrin frymë pa lejen e tij, kur pushtetin e vërtetë ai e ndan me kupolën mafioze e me oligarkët e tenderave?", shkroi dje Basha.



Debatet në Kuvend, LSI qëndron në mbledhje

PD braktis komisionet, Strazimiri: S'jemi në organizatat e drogës

PD ka vijuar me bojkotimin e komisioneve parlamentare. Por, ndryshe nga një ditë më parë, opozita nuk ka qëndruar unike. Në mbledhjen e Komisionit parlamentar të Ligjeve, deputeti demokrat Gent Strazimiri ka akuzuar mazhorancën se është në mbrojtje të kriminit. Pas kësaj, PD-ja bojkotoi komisionin. Në të kundërt, deputetët e LSI kanë vijuar të qëndrojnë në sallë për të qenë pjesë e diskutimeve. "Ky është tempulli ku përfaqësohet populli, njerëzit e ndershëm, jo organizatat e trafikut të drogës. Nuk është një vend për fshehur persona që i kërkon prurororia me provat e Antimafies italiane", u shpreh Strazimiri. Ndërkohë, deputetët i LSI, Nasip Naço paraqiti vërejtjet e tij mbi marrëveshjen me bankën gjermane për financimin e lidhjes së transmetimit të energjisë 400 KW, mes Shqipërisë dhe Maqedonisë. "Sa ndikon kjo marrëveshje huaje në borxhin publik?", ka pyetur ai. Deputetët e PD kanë vazhduar me diskutimet edhe në Komisionin e Ekonomisë, të cilin e kanë braktisur pasi kanë shprehur vërejtjet e tyre. "Hashashin nuk e sjellin qytetarët e fhjeshhtë, atë e ka sjellë qeveria, e ka përfshirë ekonominë qeveria edhe e ka bërë biznes të ditës po qeveria. Nuk kemi për ta gjetur hashashin as si biznesi i vogël, as tek qytetarët që i ke rritur taksat", u shpreh Jorida Tabaku. Ndërsa, deputetët i LSI-së, Edmond Haxhinasto: "Qëndrimi i grupit tonë do të paraqitet edhe më pas, por ne jemi kundër këtij buxheti". Pas largimit, deputeti Anastas Angjeli kishte një propozim për opozitën: "Në fakt, dy grupa ka kaluar Shqipëria në 27 vjet, një në 1997 me skemat piramidale kur ish-ministri Bode deklaroi 'falimentimin' e shtetit nga pikëpamja financiare dhe një në 2013-ën, ku po prapë i ra fati zotit Bode ta dorëzonte të falimentuar këtë shtet".

KRIMI DHE SHTETI HETIMET

Policia shqiptare u vu në ndjekje të Habilajve 50 ditë pas shkarkimit të Tahirit

"Habilajt", MD dorëzon te Krimet e Rënda 1800 faqe përgjime të përkthyer

Në dosje, provat e mbledhura nga prokurorët e Katanias

Ina Allkanjari

Prokuroria e Krimeve të Rënda tashmë zotëron 1800 faqe përgjime të Habilajve, të përkthyer në shqip. Dosja e ardhur nëpërmjet një letërporsie nga drejtësia italiane është përkthyer nga Ministria e Drejtësisë. Ndërkohë nga hetimet e kryera nga Prokuroria e Krimeve të Rënda për çështjen "Habilaj" rezulton se ndjekja e grupit të Habilajve nga policia shqiptare filloi vetëm pas largimit të Saimir Tahirit nga posti i ministrit të Brendshëm.

DOSJA ME 1800 FAQE PËRGJIME

Përkthyes të certifikuar të Ministrisë së Drejtësisë dorëzojnë pranë Prokurorisë për Krimet e Rënda dosjen me 1800 faqe përgjimesh ndaj anëtarëve të bandës së Habilajve, të përkthyer në shqip. Pritej ky material në gjuhën shqipe, që organi i akuzës të thërras për të pyetur ish-ministrin Saimir Tahiri. Shkak për përkthimin e menjëhershëm të përgjimeve mes Habilajve është bërë edhe ekstradimi i shtetasit Nazer



Prokuroria e Krimeve të Rënda

EKSTRADIMI I SEITIT

Shkak për përkthimin e menjëhershëm të përgjimeve mes "Habilajve" është bërë edhe ekstradimi i shtetasit Nazer Seiti. Kjo, pasi ndaj Seitit (një tjetër i kërkuar nga drejtësia italiane) është marrë vendimi i arrestit me afat 20-ditor, ndërkohë që për ekstradimin e tij është lënë gjithashtu 20 ditë kohë.

Seiti. Kjo, pasi ndaj Seitit (një tjetër i kërkuar nga drejtësia italiane) është marrë vendimi i arrestit me afat 20-ditor, ndërkohë që për ekstradimin e tij është lënë gjithashtu 20 ditë kohë. Megjithatë, siç është shprehur avokati i tij mbrojtës, Seiti preferon më tepër t'i dorëzohet Italisë se sa të gjykohej në Shqipëri. Ndërkohë, grupi i prokurorëve ka sekuestruar librin e takimeve nga viti 2013 deri në 2017. Bëhet fjalë për përdhën kur në krye të Minis-

trisë së Brendshme ishte Saimir Tahiri, të cilit do t'i rishikohen edhe emrat e personave që ka pritur në zyrë. Ky veprim hetimor po kryhet për të verifikuar përgjimet e italianëve ndaj njërit prej të dyshuarve në grup, shtetasit Florian Habilaj. Në funksion të këtyre hetimeve u janë kërkuar gjithashtu kompanive celulare që të dorëzojnë komunikimet telefonike të ish-ministrit të Brendshëm dhe të tre vëllezërve Habilaj si edhe qelizat e telefonave të tyre.

DOSJA "HABILAJ"

Mësohet se vetëm një muaj pasi Saimir Tahiri u shkarkua si ministër i Brendshëm dhe drejtimin e këtij dikasteri e mori Fatmir Xhafaj, policia u vu në ndjekje të Habilajve. Ishin blutë e Vlorës, që në prill 2017, i çuan materialin e parë Prokurorisë për Krime të Rënda për vëllezërit Moisi e Florian Habilaj dhe disa persona të tjerë, të dyshuar si pjesëtarë të një grupi kriminal në fushën e trafikut të drogës. Në dosjen hetimore thuhet se në datë 29 prill 2017 prokuroria regjistroi procedimin penal me nr.164 për



Gjatë një seance parlamentare

veprën penale të trafikimit të narkotikëve në bashkëpunim, mbi bazën e informacioneve referuese të shërbimeve të policisë gjyqësore të seksionit kundër narkotikëve në Drejtorinë Vendore të Policisë, Vlorë. Sipas këtyre informacioneve rezultoi se Nezar Seitaj, Moisi Habilaj, Florian Habilaj dhe shtetasi M.M. ushtronin aktivitet kriminal në fushën e trafikimit të narkotikëve. Por, nga ana tjetër, Prokuroria për Krime të Rënda po hetonte prej muajit maj të 2016 një grup kriminal të drejtuar nga Taulant Haxhiraj, që dyshohej për bashkëpunim me Habilajt. Në dosje thuhet se anëtarët e grupit kriminal në fjalë, pasi kishin siguruar sipërfaqe toke në pyll apo kullota, në pronësi të shtetit ose të personave privatë, kultivonin në to bimë narkotike në sasi nga 4500 deri në 5000

rrenjë për secilën parcelë. Sipas prokurorisë, grupi kriminal kishte vendosur lidhje me punonjës të policisë vendore, të cilët kundrejti përfitimeve monetare u siguronin mbarëvajtjen e aktivitetit të paligjshëm. Gjashtë muaj pas sinjalizimit nga policia, Krimet e Rënda firmosën arrestimin e Armand Koçerit, një prej njerëzve më të afert të Habilajve, pasi në shtëpinë e tij në Babicë të Vogël u sekuestrua një sasi prej afro 4 tonë kanabis. Pas infermierit të Babicës, në pranga ra edhe një tjetër bashkëpunëtor, Nezar Seitaj, i cili po kërkohet nga prokuroria e Katanias. Por, vetëm pas arrestimit të Moisi Habilajt në Itali, Prokuroria e Krimeve të Rënda çeli hetim ndaj ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahirit, me dyshimet për përfshirje në grupin e kushërinjve të tij.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Sigurimi i jetës, kujdesit shëndetësor dhe sigurancioni i shëndetit në udhëtim i punonjësve të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë një vjeçare"**.

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 23,694,000 Lekë**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Sigurimi i jetës, kujdesit shëndetësor dhe sigurancioni i shëndetit në udhëtim i punonjësve të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë një vjeçare"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 24 Nëntor 2017, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje pajisje kancelarie, letër format A4 dhe bojë/shiritë për printera, për nevojat e Bankës së Shqipërisë, për një periudhë një vjeçare"**.

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 8,200,000 Lekë**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje pajisje kancelarie, letër format A4 dhe bojë/shiritë për printera, për nevojat e Bankës së Shqipërisë, për një periudhë një vjeçare"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 23 Nëntor 2017, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



Kreu i PD: Shteti i krimit është shpалosur në mijëra faqe të drejtësisë italiane

Basha: Rama i zhytur në krim, shteti në shërbim të kriminelëve

"Shqipëria për investitorët e huaj, zgjedhja e fundit"

Valentina Madani

Kreu i PD-së, Lulzim Basha, akuzoi dje Edi Ramën si të vetmin kryeministër që alternativë për qytetarët ka dhunën, presionin dhe burgun. Në bindjen e tij, z.Rama ka gati gjyotinën për të varfrit dhe mburon Tahirin. Për kreun e demokratëve, shteti i krimit është shpалosur në mijëra faqe të drejtësisë italiane. Sipas Bashës, kryeministri po mburon trafikantët dhe po rrënon jetesën e shqiptarëve në mbarë vendin. "Se cili është shteti i Edi Ramës, u pa qartë çdo ditë këto 4 vite dhe e provuan në kurriz të shumicës së shqiptarëve. Sot shteti i tij i krimit është shpалosur dhe në mijëra faqe të drejtësisë italiane. Një shtet që funksionon i gjithi në shërbim të trafikantëve. Një shtet ku ministri i Brendshëm është shefi i madh i bandës. Një shtet, ku Rama vetë i bëhet pengesë drejtësisë duke e mbrojtur Tahirin, teksa bën gati gjyotinën për të varfrit që s'kanë mundësi të paguajnë ujin. Edi Rama është i vetmi kryeministër që alternativë për qytetarët ka dhunën, presionin dhe burgun, ndërsa mbrojtjen, kujdesin dhe lehtësitë i ka për trafikantët me të cilët fiton dhe ndan pushtetin", theksoi z.Basha. Ai evidentoj se: "Një kryeministër i përgjegjshëm s'do gjente qetësi derisa të krijonte mundësi për qytetarët e tij që s'paguajnë dot faturën e ujit. Ndërsa Rama i kërcënon me burg, ata që nuk sigurojnë dot as bukën e gojës. Sigurisht që për ata që janë abuzuesit më të mëdhenj nuk do ketë asnjë problem, siç ndodhi me aksionin famëkeq të energjisë, ku u shtynë drejt veëtvrasjes 12 kryefamiljarë, ndërsa oligarkët e lidhur me qeverinë vazhduan abuzime marramendëse me faturën e energjisë". Basha tha me tej se: "Një kryeministër i përgjegjshëm do orientonte investimet që hapin vende pune, do ulte taksat për biznesin, do rriste pagesën për familjet në ndihmë ekonomike dhe përmes buxhetit të shtetit, do merrte përsipër faturën e energjisë dhe ujit për familjet në pamundësi ekonomike. Dhe ky do ishte shteti për qytetarët, për hallet e përditshme të njerëzve".



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

AKUZA

Sipas kreut të PD-së, shteti i Edi Ramës është i gjithi në shërbim të tij dhe të kriminelëve të tij. Ai i shkel me këmbë qytetarët, atij nuk i duhen qytetarët. "Shteti i Ramës është i zhytur në krim dhe i kapur nga krimi", tha z.Basha.

Ish-kryeministri: Si mashtroan Kodheli dhe Bazo

Skandali i radarëve, Berisha: Prokuroria të hetojë

Ish-kryeministri Sali Berisha publikoi dje mesazhin e një qytetari dixhital, që e akuzon ish-ministren e Mbrojtjes për çështjen e mosfunksionimit të radarëve në det dhe për deklaratat të rreme. Berisha shkruan se deklaratat mashtroese e Kodhelit dhe gjeneral Bazos dëshmon se në narko-shtetin e Noriegës diktojnë narko-bandat e partisë. Ai i bën thirrje prokurorisë të hetojë. "Deklarimi i ish-ministres së Mbrojtjes, Mimi Kodheli para mediae, më datën 19 shkurt 2014 gjatë vizitës në Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD) në Plepë, Durrës, me rastin e ngritjes së kapaciteteve të vëzhgimit të hapësirës detare (e cila shoqërohej edhe nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneral major Jeronim Bazo dhe sekseristi Kraja), për vendosjen në funksion të plotë pune të Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Detare - SIVHD-së" nuk ishte i vërtetë, sepse deri në atë datë ishin vendosur në gatishmëri pune vetëm 3 nga 7 radarë të sistemit. Ky deklarim ishte një mashtrim spektakolar dhe shumë i guximshëm, veçanërisht përpara përfaqësuesve ndërkombëtarë që monitorojnë këtë qendër, mashtrim që ka vazhduar edhe në sallën e Parlamentit shqiptar (ministria Kodheli ka deklaruar që janë vendosur në muajin janar 2014). Kush të dhe faktorët që detyruan ministren të pranojë këtë lloj deklarimi jo të vërtetë kanë qenë tepër dominues, imponuese, detyruese ndaj/nga firma IDEA-TEL Sh.p.k. Firma (sepse kishte marrë 20 përqindësin (dhuratë për Krishtlindjet) duhet ta kishte realizuar kontratën për vendosjen në gatishmëri pune të sistemit deri në 15 shkurt 2014, kontratë e cila u zgjat edhe me 45 ditë të tjera edhe me një shtesë kontrate 20% tjetër (sepse Mrika u ëmbëlsua shumë nga hera e parë)", thuhet në mesazhin e qytetarit dixhital. Ai shton: "Kodheli mashtroi gjithashtu me deklaratimet si për: kohën e mosfunksionimit të sistemit (sipas deklaratimit të saj: 'jo funksional prej më se 3 vjetësh' - pra prej vitit 2011), sikurse 'mashtroen çdo herë për radarët', sikurse edhe për kostot financiare për riparimin e sistemit (referuar deklaratimit të saj: gjysmën e fondit të parashikuar nga qeveria e mëparshme)".



SKANDALI

"Sistemi i radarëve ka pasur defekt të dy radarëve gjatë vitit 2012, deri në muajin maj të vitit 2013 ka pasur në gjendje pune pjesërisht katër radarë dhe prej shtatorit 2013, vetëm dy radarë në gjendje pune, por kur sistem nuk ka qenë jashtë funksionit, pasi funksiononin në sisteme dhe mjete të tjera evidencimi -zbulimi në hapësirën detare shqiptare", thuhet në mesazhin adresuar z.Berisha.

Kryemadhi në Dibër: Krimi dhe droga kanë pushtuar Shqipërinë

Kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi, zhvilloi dje takim me elektoratin në Dibër. Kryemadhi hodhi akuza kundër qeverisë për krimin, korrupsionin, qeverisjen e keqe, papunësinë dhe nivelin e ulët të ekonomisë. Më tej ajo deklaroi se, "nëse votoni LSI-në, vota juaj është një shpresë për të sjellë ndryshimin e Dibrës dhe gjithë Shqipërisë". "Ju do pyesni se pse po e bëjmë këtë konventë? Kjo bëhet për faktin se ne i vlerësojmë anëtarët e LSI-së, mendimet dhe idetë e tyre, janë të rëndësishme për ne, parti konsiderojmë bazën me anëtarët. Marim vendime të rëndësishme në këtë situatë ku ndodhet Shqipëria. Ku krimi ka pushtuar nga çdo gjë. Ne duam ta zhvillojmë këtë shtet si evropian dhe jo si shtet



Kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi

narkotrafikant. Votat për Lëvizjen Socialiste për Integrim janë vota shprese. Njerëzit besojnë dhe dëshirojnë që ne të jemi pjesë e BE-së. Ekonomia është polarizuar, pagat nuk janë rritur, pensionet dhe pagat nuk janë rritur. Banka Botërore sapo konfirmoi se nuk kemi bërë progres, por kemi zbritur shtatë vende më poshtë. Maqedonia është në vendin e 11, ne jemi në vendin e 65. Pse? Sepse e shikojnë Sh-

qipërinë si Kolumbi. Nëse nuk zhvillohet ekonomia, atëherë shqiptarët do të jenë të varfër, do detyrohen të punojnë në fushat e kanabisit si argatë. Kështu nuk do të kenë një të ardhme të sigurt, fëmijët do të kenë vështirësi për t'u arsimuar, për shkak të shtetit që ka mbjellë krimin në vend. Prandaj dua t'ju siguroj se LSI do të punojë për qytetarët", tha zj.Kryemadhi.

Por sipas tij, "shteti i Edi Ramës është i gjithi në shërbim të tij dhe të kriminelëve të tij. Ai i shkel me këmbë qytetarët, atij nuk i duhen qytetarët. Shteti i Ramës është i zhytur në krim dhe i kapur nga krimi". Po dje kreun e PD-së reagoi pas raportit të BB "Doing Business 2018", që e renditi Shqipërinë 7 vende më poshtë se vitin e kaluar. Në një postim në 'FB', Basha tha se investitorët e huaj që duan të investojnë në Ballkan e shohin Shqipërinë si zgjedhjen e fundit. Sipas

Bashës, faktori kryesor i këtij përkeqësimi është rritja e taksave dhe detyrimeve. "Shqipëria humbet 7 vende në vlerësimin e raportit të Bankës Botërore 'Doing Business 2018'. Faktori kryesor i këtij përkeqësimi është rritja e taksave dhe detyrimeve, duke humbur plot 28 vende për këtë arsye. Raporti shprehet se 37.3% e fitimit shkon për taksa dhe kontribute, ndërkohë që qeveria zvarrit pafundësisht rimbursimin e TVSH-së. Fqinjët tanë vazhdojnë të kenë një renditje më

të mirë se sa Shqipëria, e cila renditet në vendin e 65. Maqedonia renditet në vendin e 11, Kosova në vendin e 40, Mali i Zi në vendin e 42, duke treguar përparësi krahasuar me Shqipërinë. Edhe këtë vit, ashtu si vitin e kaluar, mesazhi është shumë i qartë: Investitorët e huaj që duan të investojnë në Ballkan, e shohin Shqipërinë si zgjedhjen e fundit. Janë vendet fqinje (Maqedonia, Kosova dhe Mali i Zi) të cilat do të jenë më të afta për të thithur investitorët e huaj", deklaroi kreun e PD-së.

ZGJEDHJET PARTITE

KQZ nxjerr shifrat, partitë shpenzuan afro 250 mln lekë për 25 qershorin

Zgjedhjet, PS shpenzoi 100 mln lekë, LSI 88 dhe PD 58 mln lekë

Kërkesa e Zgurit: KQZ, fonde shtesë për monitorimin

Valentina Madani

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve publikoi dje raportet financiare të secilës prej partive për fushatën zgjedhore 2017. Partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e 25 qershorit kanë shpenzuar në fushatë rreth 250 milionë lekë. Në raportet financiare të publikuara nga KQZ rezultojnë se Partia Socialiste ka shpenzuar më shumë nga të gjitha forcat e tjera politike, plot 108 milionë lekë. Në të dhënat e detajuara vihet re se pjesa më e madhe e shpenzimeve lidhet me reklamën në media, shpenzimet për mitingje dhe materialet promovionale. Nga tabela financiare, Partia Socialiste rezultoi të ketë të ardhura rreth 98.8 milionë lekë, prej të cilave, 56 milionë lekë të ardhura të krijuara nga vetë subjekti politik, 28 milionë lekë fonde publike dhe 9 milionë lekë donacione nga persona fizik. Përsa u përket shpenzimeve, e dyta në listë renditet Lëvizja Socialiste për Integrim, me 88 milionë lekë të hedhura për fushatë. Sipas të dhënave, rezultojnë se kjo forcë politike të ardhura për fushatën zgjedhore të vitit 2017 ka grumbulluar rreth 75 milion lekë, prej të cilave 23 milionë lekë të ardhura nga fondet publike, rreth 37 milionë lekë donacione nga persona fizikë dhe juridikë dhe 13 milionë lekë të ardhura të krijuara nga vetë subjekti politik. E treta në listë përsa u përket shumës së shpenzuar në fushatë renditet Partia Demokratike me rreth 58 milionë lekë të reja, nga rreth 88 milionë lekë që ka në total të ardhura. Ashtu sikurse LSI dhe PS, pjesa më e madhe e shpenzimeve lidhen me reklama në mediat, qira për zyra elektroale, apo shpenzimet për mitingje e tubime dhe materialet promovionale. Ndërkaq, nga deklarimi i tyre në KQZ, partitë e vogla kanë shpenzuar shuma simbolike. Në formularin e dorëzuar nga partia e Ben Blushit, LIBRA, rezultojnë se forca politike ka



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

shpenzuar vetëm 730 mijë lekë, ndërsa republikanët e Fatmir Mediut, edhe pse pjesë e listës së PD-së kanë shpenzuar 2.5 milionë lekë. Kryetari i KQZ, z.Klement Zguri në mbledhjen e djeshme bëri të ditur se KQZ ka publikuar raportet financiare të fushatës zgjedhore të partive politike. Zoti Zguri

tha se raportet e depozituara nga partitë politike në KQZ tashmë janë të aksesueshme nga publiku, gazetarët, organizatat që operojnë në fushën e zgjedhjeve, pasi ato janë të publikuara në faqen zyrtare të internetit. Kryetari i KQZ-së u shpreh se moduli i financimit të partive politike në faqen zyrtare të internetit

të KQZ-së, www.cec.org.al, ku janë të publikuara raportet, është duke u zhvilluar dhe duke u pasuruar me elementë të rinj, të cilët do të lehtësojnë përdorimin dhe aksesueshmërinë e publikut. Zguri deklaroi se këtë muaj do të publikohen edhe raportet e monitorimit të fushatës zgjedhore nga ek-

FONDET

Pak kohë më parë, KQZ i kërkoi qeverisë fonde shtesë për të realizuar monitorimet e partive gjatë fushatës së zgjedhjeve. Mbikëqyrja e mënyrës se si përdoren fondet në fushatë kërkon më tepër burimeve njerëzore dhe për këtë, KQZ i kërkoi publikisht qeverisë që të japë fonde të tjera.



Foto ilustruese

SHPENZIMET E 25 QERSHORIT SIPAS PARTIVE

- Partia Socialiste - 100 884 855.00 lekë
- Lëvizja Socialiste për Integrim - 88 114 190.00 lekë
- Partia Demokratike - 58 197 289.80
- Partia Republikane - 2 499 401.00 lekë
- Aleanca Popullore - 1 209 905.36 lekë
- LIBRA - 730 630.70 lekë
- Partia Bashkimi Demokratian Shqiptar - 531 000.00 lekë

PD, Malltezi: Faktorët e humbjes më 25 qershor

PD është angazhuar në proces-analizë dhe konsultë të gjerë me të gjitha strukturat e saj. Anëtarët i kryesisë, Jamar-bër Malltezi deklaroi dje për "News 24" se situata në bazë është e vështirë, por e mira është se shumë demokratë po mblihen dhe po thonë hapur shqetësimet e tyre. "Një ndër pesë problemet kryesore të humbjes së zgjedhjeve, fushata e PD, nuk ishte aty ku duhet të ishte. Përballë një kundërshtari që nuk mbajti asnjë premtim, fushata duhet të ishte shumë më shumë agresive. Rama s'ka mbajtur asnjë premtim, ai qeveris me krimin. Ne këtu ia themi vetëm në konferenca për shtyp, gjë që nuk është e mjaftueshme. Unë jam për protesta të përditshme dhe kontakt të përditshëm me elektoratin. Nuk është



sekret që pesë faktorët kryesorë që na kanë dalë deri më tani nga analiza janë: 1. blerje votash, qoftë me para të thata dhe para shteti, 2-kërcënimi me vende pune; 3. emigracioni, 4. humbja e besimit ka dy nënkomponentë, lista e deputetëve dhe tjetra është çfarë do dilte nga marrëveshja PD dhe PS. S'di ta them në përgjigje sesa ndikim dhe rëndësi ka pasur njëra apo tjetra. Më e rëndësishme ne na del blerja e votave. Në bazë nuk del lista e



DEKLARATA

"Rezultati ishte zhgënjës dhe i pamërtuar ndaj, duhet t'i lemë të gjithë të shprehjen. Me këtë rezultat çdo demokrat ka të drejtë të shprehë dhe të na i thotë të vërtetat në sy", tha Malltezi.

deputetëve, por humbja e besimit. A kanë humbur besimin se ata nuk panë figurë që mund të kishin potencial të madh apo kanë humbur besimin se marrëveshja i krijoi iluzion të rremë të bashkëqeverisjes, s'di ta them. 5. fushata nuk ishte e duhura, mungesat në fushatë ishin të patolueshme. Të mos sulmohesh kundërshtarin për premtim të pambyllur është lë për të dëshiruar", deklaroi z.Malltezi.

Ristani: Doja të isha në sulm, Basha bëri gabim taktik

Sekretari i përgjithshëm i PD-së, Arben Ristani nuk e fsheh se kreu i PD-së, Basha gaboi me listën. "Këtu do ta ndaja pak pengëzimin ose do ta krahasoja me një ekip futboll dhe do thosha që trajneri, në rastin konkret kryetari i partisë, për mua do të ishte më mirë të më kishte vendosur në sulm se sa në mbrojtje dhe ketë e shoh si një gabim në taktikë. Por, po të mendosh që ne luamim me 'kanatiere', siç luhet futboll dhe pala tjetër luante me 'skafandra dhe me shkopinj e robokop', këtu pastaj nuk vlen më të diskutohet taktika e zgjedhur nga trajneri", tha z.Ristani për "Vizion Plus". Por, edhe pse ka qëndruar i tërhequr në muajt e fundit, Ristani do të vazhdojë të jetë pjesë aktive e politikës dhe në përputhje me detyrat e sekretarit të përgjithshëm do të merret kryesisht me çështjet e partisë. Në ditët e para pas zgjedhjeve Ristani shërbeu edhe si negociator mes Bashës dhe Patozit. Ndërsa në parti ka filluar analiza, Ristani deklaroi se e vetmja rrugë që platforma e Patozit t'i nënshtrohet diskutimit është rruga institucionale. "Në rast se ka një ide, siç është rasti konkret, për të ecur në një rrugë tjetër, do të duhet patjetër që përsëri vendimmarrja të kalojë nga organet e PD, pra nga institucionet e PD. Dhe për t'i mbledhur, statuti përcajon dhe një numër ¼ e kryesisë, e cila mund të kërkojë një mbledhje tjetër të kryesisë për të pasur vendimmarrje të re", deklaroi z.Ristani. Lidhur me kërkesën e kundërshtarëve të Bashës për rrizgjedhjen e kryetarit të partisë, Ristani është i prerë. "Kjo është një çështje e mbyllur për mendimin tim, por gjithsesi nëse do të ketë vendimmarrje të reja, këto duhet t'i marrin organet statutores të PD", u shpreh z.Ristani.

Automjetet e grabitura në Tiranë dërgoheshin në fshatin Bllicë, Peshkopi

Operacione në 3 qytete, 9 të arrestuar për drogë dhe vjedhje makinash

Policia e Shtetit: 4 aksione në Tiranë, Përmet dhe Dibër

Ina Allkanjari

Drejtori për Krimet në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Josif Shtëmbari, në një deklaratë për mediat njoftoi dje për 4 operacione të kryera në 3 qytete të vendit. Strukturat e Policisë së Shtetit gjatë aksioneve të kryera në Tiranë, Përmet dhe Dibër, kanë goditur disa grupe kriminale kryesisht për shpërndarje droge dhe vjedhje automjesh, duke vënë në pranga 9 persona. Sipas policisë 3 nga të arrestuarit janë nga Kosova.

DEKLARATA E PLOTË
Strukturat e Policisë së Shtetit në Tiranë, Përmet e Dibër, kanë kryer 4 operacione ditën e djeshme për goditjen e trafikut të narkotikëve dhe një grupi me aktivitet të fortë kriminal në fushën e vjedhjes së automjeteve. Gjatë deklaratës për mediat Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Josif Shtëmbari, bëri me dije se në Tapizë, Tiranë në bazë të informacioneve të marra në rrugë operative është bërë kontrolli e më pas arrestimi i shtetasit Astrit Voca, 19 vjeç, lindur dhe banues në Kosovë. Voca ra në



Drejtori për Krimet në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Josif Shtëmbari

pranga pasi nga kontrolli i ushtruar iu gjet dhe iu sekuestrua në cilësinë e provës materiale 4.1 kg Cannabis Sativa. Droga ishte e presuar në katër pako. Gjithashtu, 19-vjeçarit iu gjet edhe një kartë identiteti e falsifikuar. Nga hetimet

e kryera u identifikuan dhe arrestuan bashkëpunëtorët e tij Burim B., 34 vjeç dhe Shukri S., 23 vjeç, lindur dhe banues në Kosovë. Mësohet se këta dy shtetas kishin marrë me qira një automjet të markës "Volkswagen", me targa të Kosovës dhe po ndiq-

nin shtetasin Astrit Voca, për t'i krijuar siguri gjatë kohës që do udhëtonte me autobus për në Kosovë. Gjatë një aksioni tjetër policor në Tiranë, u arrestua në flagrancë shtetasi Erald Beta, 30 vjeç. Nga kontrolli fizik iu gjet dhe sekuestrua 2.8 gramë lëndë e dyshuar kokainë. Në banesë iu gjet edhe një armë zjarri pistoletë, Zaztava.

Josif Shtëmbari gjatë deklaratës bëri me dije se në një aksion tjetër policor, të zhvilluar në Përmet ra në pranga shtetasi Veis Pipa. Nga kontrolli i ushtruar në banesën e Pipas, në fshatin Panarit iu gjet një qese me lëndë të dyshuar Cannabis Sativa. Në afërsi të banesës, në vendin e quajtur "Përroi i Gropëzit" u gjetën të hedhura në një ambient të hapur 4 thasë plastmase, me ngjyrë të zezë brenda të cilëve kishte cannabis. Pe-

sha totale e lëndës rezultoi 30 kg. Sakaq mësohet se arrestimi i shtetasit Veis Pipa, 33 vjeç, u krye në flagrancë nga specialistët e Hetimit të Narkotikëve.

GRABITËSIT E MAKINAVE

Në Tiranë dhe në Dibër, gjatë operacionit të koduar "Kamionçina", u godit një grup me veprimtari kriminale në fushën e vjedhjes së automjeteve. Specialistët për Hetimin e Krimin në Komisaratin e Policisë Nr. 4 Tiranë, si rezultat i një pune policore disa mujore zbuluan dhe dokumentuan me prova ligjore veprimtarinë e grupit kriminal që vidhnin automjete dhe më pas i çmontonin për pjesë këmbimi. Mjetet vidheshin në Tiranë dhe më pas i dërgonin në një servis në fshatin Bllicë Peshkopi. Në bashkëpunim me policinë e Dibërës u arrestuan 4 persona dhe u shpall në

PERSONA NË PRANGA
Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Josif Shtëmbari, në një deklaratë për mediat njoftoi dje për arrestimin e 9 personave gjatë 4 operacioneve të kryera në 3 qytete të vendit, përkatësisht në Tiranë, Përmet dhe Dibër.

kërkim 1 tjetër. Ranë në pranga shtetasit Ferit Dauti, 44 vjeç, banues në Bllicë Dibër (i dënuar më parë); Mehmet Dauti, 20 vjeç, banues në Bllicë Dibër; Ervis Dauti 19 vjeç, banues në Bllicë Dibër; Hasan Elezaj, 49 vjeç, banues në Tiranë (i dënuar më parë). U shpall në kërkim shtetasi L. Gj., 48 vjeç, banues në Tiranë. Në servisën e shtetasit Ferit Dauti, në fshatin Bllicë të Peshkopisë, u gjetën dhe u sekuestruan në cilësinë e provës materiale 3 mjete dhe pjesë të disa makinave të tjera. Në sajë të punës hetimore të mirëorganizuar u dokumentua me prova ligjore se këta shtetas janë autor, të ngjarjes të ndodhur në 3 mars 2017, ku gjatë natës në rrugën "Sitki Çiço" kanë vjedhur mjetin tip "Benz"; ngjarjes të ndodhur në 13 gusht 2017, ku në rrugën "Arkitekt Sinani", është vjedhur mjetin tip "Benz"; ngjarjes të ndodhur 7 shtator 2017, ku në rrugën "Selman Riza", është vjedhur mjeti furgon tip "Benz"; ngjarjes të ndodhur në 23 tetor 2016, ku në rrugën "Myslym Keta", kanë vjedhur mjetin furgon tip "Benz" dhe ngjarjes të ndodhur në 23 tetor 2017, ku kanë vjedhur automjetin tip kamionçinë "Mercedes Benz". Policia e Shtetit po vijon punën për kontrollin e territorit, parandalimin e ngjarjeve kriminale dhe goditjen e paligjshmërisë.

TE DHENA	
Të arrestuarit	
➤ Astrit Voca	19 vjeç
➤ Burim. B.	34 vjeç
➤ Shukri. S.	23 vjeç
➤ Erald Beta	30 vjeç
➤ Veis Pipa	33 vjeç
➤ Ferit Dauti	44 vjeç
➤ Mehmet Dauti	20 vjeç
➤ Ervis Dauti	19 vjeç
➤ Hasan Elezaj	49 vjeç
U shpall në kërkim	
➤ L. Gj.	48 vjeç



UNHCR
The UN
Refugee Agency

The United Nations High Commissioner for Refugees (UNHCR) Representation in Albania is looking for a:

"SENIOR PROTECTION ASSOCIATE"

Terms of Reference for this position can be found on: www.un.org.al at the section of "Employment and Procurement".

Interested candidates should send the following documents (in English):

- Update P11 entry form and
- Motivation Letter

to, albt@unhcr.org or in the sealed envelope addressed to: UNHCR Albania, Skenderbej Street, Gurten Building, 2nd floor, Tirana, Albania, referring to the External Vacancy Notice: UNHCR/ALB/TIR/17/GS/02, by 14 November 2017, 5:30 p.m. CET.

Dhunuesi lihet i lirë, prokuroria: Arrestimi i A.X.H., i paligjshëm

Denoncoi durrsakun për dhunë e pengmarrje, ukrainasja me hematoma në fytyrë largohet për në atdhe

21-vjeçarja nga Ukraina, e cila denoncoi një të ri nga Durresi për dhunë e pengmarrje, u shoqërua dje nga uniformat blu për në aeroportin e Rinasit. Policia ka bërë me dije se në orët e para të mëngjesit të djeshëm vajza kishte prerë një bilete duke ju drejtuar vendit të saj, Ukrainës. 21-vjeçarja V.K. u shtrua në spitalin e durresit ditën e martë me shenja të dukshme dhune në fytyrë të ushtruara nga 24-vjeçari A.X.H.. Mësohet se Policia e Durresit kishte prerë fletë-arrestin për 24-vjeçarin, por mbrëmjen e së martës prokuroria e konsideroi si të paligjshëm arrestimin e tij duke dhënë dhe urdhërin e lirimit. A.X.H.



njihet si djali i një biznesmeni të njohur në qytetin e durresit. Deri tani policia ka bërë me dije se vajza nuk e ka tërhequr denoncimin e saj, ndërsa prokuroria ende nuk ka dhënë asnjë shpjegim zyrtar se përse u lirua 24-vjeçari, ndërkohe që nuk kishte shkuar ende në gjykatë për masë sigurie. Sipas dëshmisë së dhënë në policin, V.K. ka deklaruar se me A.X.H. ishte njohur në Mal të Zi, kur kishin qenë me pushime gjatë verës dhe kishin mbajtur kontaktet deri sa 24-vjeçari e kishte ftuar të shkonte në Durres. Mësohet se A.X.H. i kishte premtuar një lidhje të qëndrueshme, për këtë arsye e reja kishte ardhur në Shqipëri.

PAKETA FISKALE VITI 2018

Debatet në Komisionin e Ekonomisë, Tabaku e Spaho përplasen me Braçen

TVSH-ja për bizneset e vogla, opozita e çon në Kushtetuese

Qeveria do të përfshijë në skemë bizneset me xhiro mbi 2 mln lekë

Ornela Manjani

Përfshirja në skemën e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar edhe të bizneseve të vogla është kundërshtuar nga deputet e opozitës në Komisionin e Ekonomisë ku u diskutua projektligji për "Buxhetin 2018". Në skemën e re pritet të hyjnë në TVSH bizneset me xhiro vjetore mbi 2 milionë lekë ndërsa aktualisht kufiri për përfshirjen në skemë është qarkullimi vjetor mbi 5 milionë lekë. Megjithatë, sipas anëtarës së opozitës Jorida Tabaku, ky vendim pritet që të shkojë për gjykim në Gjykatën Kushtetuese. Sipas Tabakut, Buxheti 2018, do të rëndojë bizneset e vogla, ndërsa shtoi se edhe FMN-ja nuk e rekomandon vendosjen e TVSH-së. "Në cilin tregues e gjeni hashashin këtu. Ku? Te ndërtimi, tek eksportet, te shërbimet financiare? Te punësimi? Janë 649 mijë qytetarët të ndershmë që punojnë kontribuojnë në ekonominë kombëtare dhe paguajnë taksa në buxhet", - ka thënë ministri i Financave Arben Ahmetaj. Ai e shfrytëzoi prezantimin e parë të buxhetit për të hedhur poshtë një akuzë të hershme të opozitës; atë se ekonomia po rritet për shkak të parave të drogës. Por opozita këmbëngul në idenë e saj. "Mos e kërkohashashin te biznesi dhe të punësuarit. hashashi është biznes i qeverisë. Ky buxhet, ashtu si buxhetet e katër viteve më parë vazhdon varfëron shqiptarët", -tha deputetja e PD-së, Jorida Tabaku. Edhe për LSI si problem është varfëria më shumë se hashashi. Por qeveria thotë se në buxhet ka menduar edhe për shtresat në nevojë. "Meqë flisni për të varfrit vetëm 1 për qind e të pasurve sot paguajnë 17 për qind të të ardhurave që mblihen nga tatimi mbi pagën. A ka politikë më të ndershme se kjo", - u përgjigj Ahmetaj. Më herët qeveria kishte deklaruar se në skemën e TVSH-së do të



Ministri i Financave dhe i Ekonomisë, Arben Ahmetaj Komisioni i Ekonomisë

DEBATI NË KOMISION

ERJON BRAÇE: Nëse ka një reformë që akomodohet nga pikëpamja financiare buxheti i vitit 2018 është reforma në drejtësi. Ne do të bëjmë verifikimin tonë në komision për çdo qindarkë që ka nevojë ajo reformë.

EDMOND SPAHO: Kjo reforma e Saimir Tahirit, për këtë e ke fjalën?

ERJON BRAÇE: Nuk më provokon dot.

EDMOND SPAHO: Për këtë e ka fjalën... të keni turp që flisni për reformën në drejtësi, flisni ju për reformën në drejtësi...!

ERJON BRAÇE: Nuk më provokon dot me këtë gjë. Merru me akcizën e cigares dhe rakisë...

EDMOND SPAHO: Po të jeni aq pas reformës në drejtësi ia kishit hequr imunitetin, i kishit hequr imunitetin siç e kërkoi prokuroria, lërinë proçakt tani na tregon reformën... të kesh turp që zë në gojë reformën në drejtësi. E kishe rastin atje të enjten e kaluar që të votoje imunitetin, por nuk jeni nga ata burra se jeni të zhytur kokë e këmbë në drogë dhe nxirri njëri-tjetrin dhe atë drunë e shtrembër që tha ditën e parë u detyruar ta gëlltisë ditën tjetër, sepse e kërcënuan, që po dola unë del dhe ti. Dhe na tregon tani reformën në drejtësi, çfarë reforme në drejtësi mor, qesharak.

përfshihen të gjitha bizneset e vogla, duke mbyllur kështu zinxhirin e transakcioneve. Mirëpo ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj, tha se pragu do të ulej nga 5 milionë në 2 milionë, duke lënë jashtë skemës fermerët, artizanët dhe një grup profesioneesh.

TABAKU

"Mos e kërkohashashin te biznesi dhe të punësuarit. hashashi është biznes i qeverisë. Ky buxhet, ashtu si buxhetet e katër viteve më parë vazhdon varfëron shqiptarët", -tha deputetja e PD-së, Jorida Tabaku.



Komisioni i Ekonomisë

Drafti



PROPOZIMET

Dhoma Amerikane e Tregtisë ka dorëzuar zyrtarisht 23 komente dhe rekomandime. Në draft, Dhoma analizon ndryshimet ligjore të paketes fiskale ku shpreh rezervë për logaritjen e taksës së pronës dhe për lënie jashtë paketës së masave për uljen e dividendit dhe tatimit mbi të ardhurat personale.

10 PROPOZIMET E DHOMËS SË TREGTISË PËR PAKETËN 2018

■ TVSH 0 për tregtinë me pakicë, rishikim të tatimitimit e tatimi për pagat
Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë në bashkëpunim me Shoqatat e Biznesit (Shoqata e Prodhuesve, Shoqata e Ndërtuesve, Shoqata e Turizmit, Shoqata e Fasonit, Shoqata e Kombëtare e Grave Profesioniste, Afariste dhe Zejtare, Shoqata e Transportit etj...) pas konsultimeve për Paketën Fiskale 2018, kërkon të merren në konsideratë 10 propozime.

A- Për politikat fiskale propozohet sa më poshtë:

1- Të bëhet një amnistie fiskale, "tax amnesty" për legalizimin e kapitalit, deri në vitin 2015, e cila përfshin deklarimin dhe pagesën e detyrimeve për një afat 6-mujor për të gjithë kategoritë e tatimpaguesve dhe individëve me një tarifë tatim 2-5%, me bazë të gjerë dhe që përfshin përveç biznesit edhe individin me përjashtim të individëve që kanë detyrim ligjor deklarimin në ILDKP.

2- Biznesi i vogël që përfshihet në TVSH, të ketë prag përjashtimi sikur sot për 5 milionë lekë për kategoritë e shërbimeve, profesioneve të lira dhe të tjera, përveç aktivitetit tregtar dhe prodhues, tregtia me pakicë, të cilët kalojnë me zero për qind TVSH;

3- Subjekte të BV me xhiro deri në 2 milionë lekë pa tatim fitimi ose zero %;

4- Subjekte të BV me xhiro 2 deri në 14 milionë lekë me 5% tatim fitimi;

5- Subjekte me xhiro më të lartë se 14

milionë lekë të jenë me tatim fitimi 10%.

6- Tatimi mbi të ardhurat, për kalimin e pasurisë (neni-11 i ligjit nr.8438, ose pika-2.7 e udhëzimit nr.5) të jetë zero %, për shitjen e shtëpisë (apartamentit) të parë apo ku jeton individi për më shumë se 3-vite, të gjithë shtëpitë e tjera (dyta) dhe të tjera ndërtime të jenë me tatim 5%.

7- Taksa e pasurisë (m2) me aplikim mbi vlerën e tregut të jetë 0.05% për banesën ku jeton dhe 0.1% për apartamentet e dyta e me radhë. Taksa e pasurisë për ambientet tregtare dhe zyra të jetë 0.15%, përveç kabanone dhe magazina, të cilat duhet të trajtohen me 0.05% të vlerës.

8- Tatimi mbi të ardhurat të jetë për pagat në nivelin deri 35.000 lekë 0%, mbi 35.000-335.000 lekë 10%, mbi 335.000 lekë me 20%, po kështu të ardhura nga qira dhe çdo e ardhur tjetër sipas deklaratës personale (me detyrime 5% tatim për të ardhura deri 14 milionë dhe 10% për të ardhura 14-28 milionë lekë dhe 20% mbi 28 milionë lekë).

9- Për të mundësuar dhe formalizuar punësimin e të rinjve, pagesa e kontributit për një periudhë kalendrike, 90 ditore si për studentët gjatë verës (3-mujor korrik-shtator) dhe për stazhier vitin e parë të punësimit të jetë në masën e kontributit për sigurimin shëndetësor dhe aksidenteve në punë ose në total për 3.7% të pagës bruto (sikur trajtohen sot për punonjës më me pak se 87 orë punë/vit).

10- Të hiqet kufiri i detyrueshëm për pagën minimale të përcaktuar me VKM nr.399, apo akteve të tjera n/ligjore pasi tregu i punës dhe disa aktivitetet janë realisht nën këtë pagesë.



Taksa për shtëpitë do të jetë 0.05 % e vlerës së tregut të ndërtimit. Përfshirja në skemën e taksimit për ndërtimet në proces legalizimi është vendosur në paketën fiskale të vitit 2018, e cila ka marrë dje miratimin e Këshillit të Ministrave. "Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", thuhet në projektligjin e miratuar dje. Sipas të dhënave nga ALUIZNI, numri i lejeve për legalizim për periudhën 2006-maj 2017 është 132.000 objekte, nga të cilat 108.240 janë banesa dhe pjesa tjetër 23.760 janë objekte biznesi. "Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të palu-

Taksa mbi shtëpi 0.05%. Ja sa do të paguani për shtëpitë para 93-shit

Taksa mbi pronën, përfshihen edhe ndërtimet pa leje



Foto ilustruese

ajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në këtë ligj përcaktohen ndryshe. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje". Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen zhvilluesit, të

shtrihen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje". Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen zhvilluesit, të

cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përlogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi. Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën. "- thuhet në nenin 22 të projektligjit për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Taksa e pronës për biznesin do të jetë përqindje e vlerës

Veliaj: Taksimi progresiv, të jetë 0.25% e vlerës së pronës

Ndryshimi i formulës sjell deri në 3 milionë euro të ardhura në vit

Ornela Manjani

Bashkia e Tiranës do të propozojë Kuvendit ndryshimin e taksës së pronës për biznesin, duke aplikuar taksimin progresiv. Lajmi u bë me dije nga kryebashkiaku, Erion Veliaj, gjatë Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me atë Vendors, duke theksuar se kjo taksë duhet të jetë 0.25% e vlerës së pronës. Gjithashtu, Veliaj tha se janë të domosdoshme ndryshime në buxhet për shërbimin zjarfikës, duke kërkuar që transferata të bëhet në bazë të emergjencave.

PROPOZIMI

"Kemi disa propozime për përmirësim, pra deri tani thamë lajmet e mira, tani kemi lajmet e gjërave që mund të bëhen akoma edhe më mirë. Një prej tyre ka të bëjë me taksën e pronës për bizneset. Është shumë e mirë që, siç kemi kaluar, edhe granti është si përqindje e GDP-së, edhe taksa e pronës do të jetë përqindje e vlerës. Tek familjarët kjo nuk ndryshon, s'ka asnjë efekt, por te bizneset, dhe këtu vetëm këtë po flas politikisht se unë jam socialist dhe, siç aplikohet në Bashkinë e Tiranës, ai që ka më shumë do paguajë më shumë, pra milioneri që bën pallate do paguajë më shumë se sa ai që ka një furrë buke.



Kryebashkiaku, Erion Veliaj, gjatë Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me atë Vendors

Unë besoj që me të njëjtën filozofi të taksimit progresiv ne nuk mundet që të aplikojmë të njëjtën taksë prone për familjarët, tani si përqindje e vlerës, jo si tarifë fikse për metër katror. Pra, ne na rezulton që për bizneset e mëdha, që kanë pronë që sipas indeksit të hipotekës metri katror vlen më shumë se sa 3 milionë lekë këta po marrin zbritje. Nuk është e ndershme. Pra, biznesi i madh, i madh fare, kryesisht banka multinacionale, kompani celulare, që tashmë e paguajnë me mbi 10%

këtë gjë, pse po i japim një ulje që as ata nuk e kanë kërkuar. Parimi duhet të ndjek progresivitetin. Pra, të mëdhenjtë fare, që as nuk na kanë kërkuar këtë, për ata është, për ata është në nivel qindarkash. Po të na pyesin ne bashkitë, për ne është gjithçka, se për 1 bashki 1-2.3 milionë euro bëjnë gjithë diferencën në buxhet. Kështu që, do doja që ta shikonim këtë, besoj që jemi ende në kohë. Do t'i kërkoj edhe zotit Braçe që drejton komisionin në parlament që ta adresojë, propozimi ynë konkret është

SHKALLA E TATIMIT

Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është si më poshtë: 0.05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim; 0.15% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike dhe 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtim.

TAKSA MBI NDËRTESAT

1. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në këtë ligj përcaktohen ndryshe.
2. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje".
3. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përlogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.
4. Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën.

tij në vitet në vijim ajo duhet të jetë më e lartë. "Besoj që një nga vlerësimet ka të bëjë me rritjen e transferitës së pakushtëzuar në 1 përqind të Produktit të Brendshëm Bruto. Sigurisht që ne kemi avokuar që të jetë më shumë se 1 përqind e GDP-së, por vetëm fakti që tashmë është fiksuar si pjesë e të tërës e bën transferitën e pakushtëzuar, pak më të madhe. Do të thotë që secila bashki në bazë të formulës ka një mundësi më të madhe për të financuar nevojat e veta." Gjatë takimit, kryebashkiaku kërkoi më tepër kompetenca për qeverisjen vendore edhe në drejtim të aktiviteteve të biznesit që disponojnë leje mjedisore të kategorisë C, duke argumentuar se aktualisht bashkia e ka të pamundur të ndërrhyjë për të disiplinuar pozitivet. Ai e konsideroi pozitiv edhe parashikimin tjetër që bën ky projektbuxhet dhe që ka të bëjë me tatimin e të ardhurave që gjen-

erohen në një bashki të caktuar në favor të pushtetit vendor, cka sipas kryebashkiakut Veliaj do të ndikojë edhe në rritjen e punësimin. "Fakti që për herë të parë bashkitë do të marrin 2% të tatimit të të ardhurave që gjenohen në atë bashki është një lajm shumë i mirë. Deri dje ka qenë vetëm në varësi të dëshirës apo pasionit të kryetarëve të bashkive çështja e punësimin, sepse nuk ka pasur asnjë lidhje punësimi i qytetarëve të bashkisë tënde me të ardhurat e bashkisë. Sot që bashkitë do të marrin qoftë edhe këtë përqindjen modeste nga tatimi i të ardhurave, do të thotë që çdo kryetar bashkie automatikisht do të incentivohet për çdo vend pune që do të krijohet në atë bashki, sepse do të marrë 2% të tatimit të të ardhurave. Pra, tatimi i të ardhurave nuk ndryshon, por vetëm mënyra se si shpërndahet", shtoi Veliaj.

Autori u gjet i fshehur në një kamp rom. Urdhri për ekzekutimin e viktimës u dha nga burgu i Koridhalosë

Vrasja e avokatit, shqiptari: Doja vetëm ta trembja

Policia greke: 32-vjeçari mori 3000 euro parapagesë për krimin

Egla Xhemali

GREQI

Unë nuk doja ta vrisja avokatin Mihal Zafiroopoulos, doja vetëm ta trembja". Kështu ka deklaruar dje gjatë marrjes në pyetje nga policia greke shqiptari 32-vjeçar, i cili dyshohet të jetë autori për vrasjen e avokatit të njohur më 12 tetor. Por, pavarësisht kësaj deklaratë, mediat greke kanë nxjerrë dje detaje të reja në lidhje me krimin. Burime për "Gazeta Shqiptare" bënë me dije se shqiptarët e marrë në pyetje janë Albert Bako, Olti Dulçe dhe një tjetër me emrin Klodian. Ditën e djeshme u raportua se autori i vrasjes është një 32-vjeçar i arratisur nga burgu i Kasandrës. Mësohet se shqiptari kishte ikur me leje nga burgu, por nuk ishte kthyer më, duke kryer edhe krimin. Ndërkaq, thuhet se urdhri për vrasjen e avokatit grek ishte dhënë nga burgu i Koridhalosë. Po kështu, raportohet se shqiptari kishte marrë 3000 euro parapagesë për vrasjen. Ai u gjet në një kamp rom, ku i fshihej policisë pas krimit. Vrasja e avokatit grek, Mixalis Zafeiropoulos më 12 tetor në mes të Athinës ka vënë në lëvizje policinë e vendit fqinj. Në kuadër të këtij hetimi, siç mëson "Gazeta Shqiptare" janë marrë në pyetje tre të dënuar shqiptarë në burgun e Koridhalosë, pasi kanë qenë më herët të përfshirë në një tentativë vrasjeje ndaj një tjetër avokati grek, të quajtur George Antonopoulos.



Avokati Mihal Zafiroopoulos

VRASJA

Mixalis Zafeiropoulos u vra në armën e tij ligjore më 12 tetor. Nga hetimet e deritanishme dyshohet se autorët kanë dashur ta trembin avokatin dhe t'i përcillnin atij një mesazh, por debati ka degraduar duke e qëlluar atë për vdekje.

ARRESTIMI

Pas rinisjes së hetimeve për vrasjen e avokatit grek, i ekzekutuar në mes të Athinës më 12 tetor, autoritetet greke kanë vënë në pranga një 32-vjeçar shqiptar, i cili dyshohet se është autori i vrasjes së

avokatit Mixalis Zafeiropoulos. Sipas mediave greke, policia bastisi shtëpinë e shqiptarit pasditen e së dielës në lagjen "Kallitha", ku u gjetën armë zjarri. 32-vjeçari ishte përpjekur të arratisesh në Itali e Shqipëri, por nuk ia doli dhe u

arrestua në Patra. Policia greke është në kërkim të dy bashkëpunëtorëve të tjerë të shqiptarit, të cilët dyshohen se janë përfshirë në vrasjen e Mixalis Zafeiropoulos. Emri i shqiptarit të arrestuar nuk bëhet me dije, ndërsa mësohet se është emër i njohur për autoritetet Helene. Mixalis Zafeiropoulos u vra në armën e tij ligjore më 12 tetor. Nga hetimet e deritanishme dyshohet se autorët kanë dashur ta trembin avokatin dhe t'i përcillnin atij një mesazh, por debati ka degraduar duke e qëlluar atë për vdekje. Të hënën policia mori në pyetje edhe 3 shqiptarë të tjerë, të cilët vuajnë dënimin në burgun e Koridhalosë, si persona që mund të kenë dijeni për vrasësit e avokatit.



Hashim Isufi, i dënuar me 18 vite

Tentoi të vriste bashkëfshatarin në '98-ën, arrestohet shqiptari

GREQI - Policia greke ka identifikuar shqiptarin e arrestuar në Greqi ditën e mërkurë, pasi ishte dënuar me 18 vite burg për një ngjarje të ndodhur në Shqipëri 19 vite më parë. Shtetasi Hashim Isufi, 55 vjeç, është arrestuar në Selanik më datën 31.10.2017, si rezultat i bashkëpunimit të Interpol Tiranës me Interpol Athinën. 55-vjeçari Hashim Isufi, banues në Ferraj, në Tiranë, ishte i shpallur në kërkim ndërkombëtar, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendim penal nr. 278 datë 04.05.1999 e ka dënuar këtë shtetas me 18 vjet burg për veprat penale "Vrasje me paramendim e mbetur në tentativë" dhe "Armëmbajtje pa leje", të parashikuar nga nenet 78-22 dhe 278/2 të Kodit Penal. Kapja dhe arrestimi i tij në Selanik u bë për qëllim ekstradimi në Shqipëri. Ngjarja për të cilën akuzohet Hashim Isufi ka ndodhur 19 vite më parë. Më datë 05.03.1998, rreth orës 17:00, në fshatin Ferraj të Tiranës ka qëlluar tri herë me armë zjarri pistoletë në drejtim të shtetasit L.V., i cili si pasojë e të shtënave ka mbetur i plagosur rëndë. Burime policore të asokohe bënë me dije se Hashim Isufi i është afruar shtetasit të plagosur dhe ka tentuar ta qëllojë përsëri, por i është bllokuar arma e zjarrit dhe më pas është larguar me shpejtësi nga vendi i ngjarjes.

DËNIMI

Hashim Isufi ishte i shpallur në kërkim ndërkombëtar, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendim penal nr. 278 datë 04.05.1999 e ka dënuar atë me 18 vjet burg për veprat penale "Vrasje me paramendim e mbetur në tentativë" dhe "Armëmbajtje pa leje".

unicef | for every child

UNITED NATIONS CHILDREN'S FUND (UNICEF)
Albania Country office

REQUEST FOR PROPOSAL FOR SERVICES

Subject: Conduct a Research on Children's Experiences of Internet Use in Albania.

The United Nations Children's Fund (UNICEF) is seeking to receive proposals from interested organizations/companies who wish to be considered for the provision of the above-mentioned services/works.

Please consult UNICEF Albania website (www.unicef.org/albania) to download the detailed RFPs solicitation document and other related requirements.

The proposals will be evaluated and selected in accordance with established UNICEF procedures.

The offers must be delivered within the set deadline, in a sealed envelope which must be clearly marked: "LRPS-2017-9135451 - Research on Children's Experiences of Internet Use" to the address below:

United Nations Children's Fund (UNICEF)
Rr. "Skënderbej", ndërtesa e Agjencive të OKB-së, kati i tretë, Tiranë, Albania
Tel.: +355 4 2273 335/6/7/8/9; fax: +355 4 2243 775 /6
Website: www.unicef.org/albania

Relevant Dates: All interested companies must submit their application, not later than **13 November 2017, 16:30 hrs.**

Policia: Droga, me destinacion Turqinë

Sekuestrohen 750 kg marijuanë në kufi mes Maqedonisë dhe Kosovës

MAQEDONI - Ditën e djeshme policia ka sekuestruar 750 kg drogë në pikën kufitare mes Kosovës dhe Maqedonisë, respektivisht në vendin e quajtur Bllacë. Sipas portalit "Tetova1", droga është gjetur në një kamion të madh transportues, ndërkohë që janë duke u marrë të gjitha masat që të vërtetohet se kush e ka porositur sasinë e lëndës narkotike dhe ku ka qenë destinacioni i fundit. Sipas drejtorit të Drejtorisë së Doganave, Gjoko Tanasoski, droga vinte nga Kosova dhe për destinacion përfundimtar kishte Turqinë. Autoritetet doganore kishin dyshime për transport ilegal të marijuanës, ndërsa drejtuesi i automjetit ku u gjet droga ka mundur të arratiset nga pika kufitare, duke i shpëtuar arrestimit të policisë. Edhe pse drejtuesi është arratisur, ai ka lënë në automjet dokumentet e identifikimit dhe sipas policisë, ai është një shtetas maqedonas. Policia në bashkëpunim me prokurorinë po heton rastin, ndërsa dyshohet se pas kësaj, mund të jetë një rrjet trafikantësh. Policia bë me dije se sasia e marijuanës e sekuestruar në Bllacë kapte vlerën e 4 milionë eurove.

Mediat gjermane: Janë trajtuar vetëm 18 mijë raste

Zgjatën procedurat për azilkërkuesit në Gjermani, ja cilat janë arsyet

Ndryshimet në personelin e Zyrës Federale për Migracionin dhe Refugjatët kanë bërë që kërkesat për azil të trajtohen me vonesë. Gazeta gjermane "Nürnberg Nachrichten" bën me dije se kjo zyrë emigracioni, BAMF tashmë ka ulur rendimentin e punës dhe ka arritur të trajtojë vetëm 15-18 mijë dosje azilkërkuesish, nga 50 mijë raste që ka arritur të shqyrtojë më parë. Deri në fund të vitit kjo instancë duhet të trajtojë edhe 44.000 kërkesa për azil, por nga shtatori kësaj shifre i shtohen 52.000 kërkesa të mbetura nga e shkuara si edhe 48.000 kërkesa të reja për azil. Ishte parashikuar

KERKESA

Në shtator arritën të gjenin një vend në kurset e integritimit 28 mijë persona, që përbëjnë vetëm gjysmën e kërkesave aktuale për kurse integritimi. Mesatarisht azilantët duhet të presin gjashtë muaj për të gjetur një vend në kursin e integritimit.

që dosjet e muajit maj të 2016-ës do të kishin mbaruar së verifikuari brenda këtij viti, por ngadalësimi në procesin e punës nuk e ka bërë të mundur të arrihen objektivat e paracaktuara. Por

edhe në ofrimin e kurseve të integritimit janë hasur probleme. Në shtator arritën të gjenin një vend në kurset e integritimit, 28 mijë persona, që përbën vetëm gjysmën e kërkesave aktuale për kurse

integritimi. Mesatarisht azilantët duhet të presin gjashtë muaj për të gjetur një vend në kursin e integritimit. Për herë të parë në dy vjet, numri i rasteve të hapura për azil në Zyrën Federale për Migracionin dhe Refugjatët ka rënë nën 100.000. Në fillim të shtatorit, kishte vetëm 99.334 kërkesa për azil të papërpunuara. Një vit më parë, shumë aplikime të papërpunuara ishin dorëzuar në tavolinat e autoriteteve. Por në 2015 dhe 2016, BAMF



Foto ilustruese

kishte marrë kaq shumë aplikime sa që zyrarët ishin gjithmonë në punë pas orarit. Portali gjerman "Zeit Online" bën me dije se vitin e kaluar, 430 mijë procedura u ndaluan e nga fillimi i janarit deri në fund të shtatorit 2017, pothuajse 140.000 aplikime të

reja u shtuan. Puna e BAMF-it ende vlerësohet në mënyrë kritike. Për një efikasitet më të lartë, agjencia kishte angazhuar agjencinë konsultuese McKinsey, e cila më pas u ankua për presionin dhe frikën mbi të punësuarit.

Projektligji i dorëzuar tri ditë më parë në Kuvend, për shqyrtim e miratim

Amendamenti i PD: Të jepen falas tekstet mësimore për shkollat 9-vjeçare

Partia Demokratike: Do ishte ndihmë për të varfrit

Voltiza Duro

Amendamenti i dorëzuar në Kuvend nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, parashikon që tekstet mësimore për nxënësit e shkollave 9-vjeçare të jepen falas. Projektligji "Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 69/2012 për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i dorëzuar tri ditë më parë është propozuar që të merret në shqyrtim dhe të miratohet nga Kuvendi. "Shpenzimet për tekstet shkollore dhe ato ndihmë të nxënësve në arsimin publik, nga klasa e parë deri në klasën e nëntë, mbulojnë plotësisht nga buxheti i shtetit. Tekstet shkollore të paguara nga shtetit, ka qenë një propozim i kryetarit të Partisë Demokratike, Lulzim Basha prej kohësh. Qeveria vazhdimisht ka refuzuar ta marrë në konsideratë. Shumë vende të rajonit e kanë këtë model, si dhe një pjesë e madhe e vendeve të BE. Tekstet falas për nxënësit, do të ishin një ndihmesë për familjet e varfëra shqiptare, që kanë një prej shpenzimeve më të mëdha të vitit blerjen e librave për fëmijët", citohet në njoftimin e PD-së. Në projektligj theksohet se shpërndarja falas e teksteve mësimore do të krijojë mundësinë që të gjithë nxënësit të ndihen të barabartë dhe madje në këtë mënyrë do të lehtësohet edhe puna e mësuesit. "Gjithashtu, në kushtet e



Projektligji i dorëzuar në Parlament nga PD-ja

PROJEKTLIGJI

"Gjithashtu në kushtet e përhapjes së fenomenit të braktisjes shkollore, pamundësisë ekonomike, për shkak të varfërisë, dhënia e teksteve mësimore dhe atyre ndihmëse falas do të ishte një masë që do të shërbente shumë në uljen e fenomenit të braktisjes shkollore, si dhe në krijimin e një klime shumë më pozitive në lidhjen mes shkollës-nxënësit dhe komunitetit të prindërve", thuhet në projektligj.

përhapjes së fenomenit të braktisjes shkollore, pamundësisë ekonomike, për shkak të varfërisë, dhënia e teksteve mësimore dhe atyre ndihmëse falas, do të ishte një masë që do të shërbente shumë në uljen e fenomenit të braktisjes shkollore si dhe në krijimin e një klime shumë më pozitive në lidhjen mes shkollës-nxënësit dhe komunitetit të prindërve", thuhet në projektligj. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka dërguar bashkangjitur për shqyrtim edhe relacionin në të cilin jepen argumente lidhur me përparësitë dhe efektet e prishmë të projektaktit. "Në vlerësimin e specialistëve dhe ekspertëve të arsimit, një nga shkaqet e rritjes së fenomenit të braktisjes shkollore, është edhe aspekti ekonomik, që do të thotë

PRITSHMËRITË

Në projektligj theksohet se shpërndarja falas e teksteve mësimore do të krijojë mundësinë që të gjithë nxënësit të ndihen të barabartë dhe madje në këtë mënyrë do të lehtësohet edhe puna e mësuesit. Gjithashtu, thuhet se kjo do të ishte një masë që do të shërbente shumë në uljen e fenomenit të braktisjes shkollore.

pamundësia e familjeve shqiptare për të mundësuar blerjen e librave shkollore. Në vlerësimin e fundit të Bankës Botërore, rreth 180 mijë familje jetojnë në varfëri ekstreme me më pak se 3 USD në ditë, çka e bën një nevojë imediate miratimin e këtij ndryshimi në ligjin 69/2012", citohet në relacion. Në vijim të këtij të fundit thuhet se dhënia e teksteve falas është një praktikë e zbatuar me sukses në vendet e rajonit tonë si Greqi, Maqedoni dhe Kosova dhe ka krijuar

prej vitesh një impakt pozitiv jo vetëm në aspektin mësimdhënës, por edhe në krijimin e një klime më bashkëpunuese në shkollë dhe në komunitetin e prindërve. Pas dorëzimit të projektligjit "Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 69/2012 për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", Grupi Parlamentar i PD-së kërkon menjëherë vijimin e procedurave të nevojshme parlamentare në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.



TENDER NOTIFICATION

"Training Centre Furniture" in the frame of the project: "Direct funding to INSTAT for procurement of IT-equipment and establishing the training centre."
Sida contribution 55020289

Institute of Statistics of Albania intends to award a supply contract for "Training Centre Furniture" for the project funds: "Direct funding to INSTAT for procurement of IT-equipment and establishing the training centre." in Tirana, Albania. The project is financially supported by the Government of Sweden represented by the Swedish International Development Cooperation Agency (Sida).

The tender dossier is available from 24.10.2017 at www.instat.gov.al, www.app.gov.al

The deadline for submission of tenders is November 23, 2017, 11:00 hrs local time, at Institute of Statistics of Albania, Bul. Zhan D'Ark, Nr. 3, Tirana, Albania. Possible additional information or clarifications/questions shall be published on the www.instat.gov.al and <https://www.kommersannonns.se/sida/>.

Tenderers may request clarification on any of the documents of the Tender not later than 14 days before the deadline for submission of bids.

Ambasada: Programi 'Global UGRAD', çfarë përfitojnë fituesit

Bursa studimi në Amerikë, kriteret që ju kualifikojnë

Ja cilat janë afatet e fundit të aplikimit

Voltiza Duro

Brenda dy muajsh të gjithë studentët e nivelit të parë kanë mundësi të aplikojnë për bursë për të ndjekur studimet për një semestër në universitetet amerikane. Ky njoftim është përcjellë nga Ambasada amerikane në Tiranë, e cila ka bërë me dije se të interesuarit duhet të aplikojnë fillimisht në programin "Global UGRAD". Ky i fundit është një program i financuar nga Departamenti i Shtetit Amerikan, i hapur për të gjitha fushat e studimit dhe nuk është diskriminues ndaj racës, ngjyrës, gjinisë, orientimit seksual, fesë, etnisë, ose paafësisë fizike. "Bursa mbulon udhëtimin, shkollimin, dhomën, siguracionin për aksidente apo sëmundje, një pagesë të vogël mujore dhe shpenzime për libra. Pjesëmarrësit jetojnë në konvikte me bashkëmohatarët e tyre amerikanë, ose në banesa me familje amerikane", -thuhet në faqen zyrtare të ambasadës.



Ambasada amerikane në Tiranë

aksidente apo sëmundje, një pagesë të vogël mujore dhe shpenzime për libra. Pjesëmarrësit jetojnë në konvikte me bashkëmohatarët e tyre amerikanë, ose në banesa me familje amerikane", -thuhet në faqen zyrtare të ambasadës.

KËRKESAT PËR KUALIFIKIM

Programi "Global UGRAD" është i hapur për të gjithë shtetasit shqiptarë rezidentë mbi 18 vjeç që kanë mbaruar vitin e parë në universitet. Këta kandidatë duhet të jenë të regjistruar si student në çdo

BURSA

"Bursa mbulon udhëtimin, shkollimin, dhomën, siguracionin për aksidente apo sëmundje, një pagesë të vogël mujore dhe shpenzime për libra. Pjesëmarrësit jetojnë në konvikte me bashkëmohatarët e tyre amerikanë ose në banesa me familje amerikane", thuhet në faqen zyrtare të ambasadës.

univërsitet të akredituar, publik ose privat dhe duhet të kenë të paktën një semestër për të kryer në vendin e tyre në përfundim të programit "Global UGRAD". Gjithashtu, njohuritë e mira në gjuhën angleze përbëjnë një ndër kriteret që duhet të plotësohen

KËRKESAT PËR KUALIFIKIM MBI 18 VJEÇ

- Shtetas shqiptar, aktualisht rezident në këtë shtet.
- Të ketë mbaruar vitin e parë të universitetit përpara se të fillojnë programin "Global UGRAD".
- I regjistruar si student në çdo universitet të akredituar, publik ose privat, dhe ka të paktën një semestër për të kryer në vendin e tij në përfundim të programit "Global UGRAD". Programi "Global UGRAD" nuk mund të konsiderohet si semestër përmbyllës për një student universiteti.
- Njohuri të mira të gjuhës angleze të folur dhe të shkruar (Një program trajnimi për përmirësimin e gjuhës angleze, mundësohet për disa finalistë); të aftë për të filluar studimet në Shtetet e Bashkuara në gusht 2018 ose janar 2019 (kandidatët e zgjedhur nuk mund të fillojnë me vonë se këto data).
- Të ligjëshëm për t'u pajisur me vizën amerikane për studentët (J-1), që nevojitet për këtë program.
- Të ndërgjegjshëm për t'u kthyer në vendin e tyre pas përfundimit të programit.

për aplikim. Kandidatët duhet të jenë të ligjëshëm për t'u pajisur me vizën amerikane për studentët, (J-1) që nevojitet e të ndërgjegjshëm për t'u kthyer në vendin e tyre pas përfundimit të programit. Kandidatët duhet të jenë të kujdesshëm që aplikimi të përbëjë: një ese, kopjen e pasaportës biometrike ose kartën e identitetit, listën zyrtare të notave të universitetit, dy letra reference në anglisht, ekuivalentimin e notave sipas sistemit amerikan dhe normalisht, aplikimin e bërë nëpërmjet 'Google Chrome' apo 'Mozilla Firefox'. "Global UGRAD" është një program shkëmbimi i pavarur, i konceptuar për t'i ekspozuar studentët ndaj sistemit arsimor,

shoqëror dhe kulturor amerikan. Por, ambasada gjithashtu bën me dije se kandidatët që nuk plotësojnë kriteret, nuk do të mund të kualifikohen për t'u bërë pjesë e programit. Kështu, të gjithë ata që janë qytetarë amerikanë dhe banues të përhershëm në SHBA nuk përzgjidhen. Gjithashtu, nuk kualifikohen edhe personat që aktualisht studiojnë, jetojnë, ose punojnë jashtë vendit të tyre apo janë punonjës vendës të misioneve amerikane, të cilët punojnë për Departamentin e Shtetit dhe/ose për Agjencinë Ndërkombëtare të Zhvillimit. Ambasada thekson se kandidatët kanë afat për të aplikuar deri më datën 31 dhjetor të këtij viti.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇEM I APELITIT

SHPLLJE E VENDEVE VAKANTE

Kolegji i Posaçëm i Apelitit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimin e Kuvendit nr.92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të kolegjit të Posaçëm të Apelitit", shpall vendet vakante për pozicionet:

1. SPECIALIST FINANCË/BUXHET

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:

- a. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Ekonomi, Dega Financë.
- b. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- c. Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në profesion.
- d. Të ketë njohuri në programet financiare si: Alpha/Financa 5 etj.

2. SPECIALIST I BURIMEVE NJERËZORE

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:

- a. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor".
- b. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- c. Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në fushën e burimeve njerëzore.

3. SPECIALIST IT

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:

- a. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Inxhinieri Informatike, Informatikë, Teknologji informacioni etj.
- b. Të ketë të paktën 3 vite eksperience pune në fushën e teknologjisë së informacionit.
- c. Të ketë njohuri shumë të mira në administrimin e sistemeve si Active Directory, Outlook Mail Client
- d. Të ketë njohuri bazë mbi pajisjet e rrjetit dhe infrastrukturën e rrjetit.
- e. Të ketë njohuri bazë për panelet e administrimit të faqeve web (Wordpress, Drupal, Joomla etj).
- f. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

4. SPECIALIST PROTOKOLL/ARKIVE

Kandidati duhet të plotësojë këto kriteret:

- a. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor".
- b. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze
- c. Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

KUSHTE TË PËRGJITHSHME

- Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për tu pajisur me Certifikate Sigurie, sipas Vendimit Këshillit Ministrave nr.188, datë 4.3.2015.
- Kandidatët duhet të kenë aftësi për tu përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 6 Nëntor deri më 10 Nëntor 2017 në një nga formatet e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së Kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: **Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Pallati i Kongreseve, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.**

- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: **"Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Pallati i Kongreseve, Tiranë.** Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 10 Nëntor 2017, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatit e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 6 Nëntor deri më 10 Nëntor 2017 në adresën: **info@kpa.al.** KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
2. Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) original ose të noterizuar. Diplomat që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njuhësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
4. Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
5. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
6. Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
7. Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnimet, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet positive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Emigranti 29-vjeçar u plagos nga policia, ndodhet nën arrest

Sulmi me kamion në Nju Jork, autori nga Uzbekistani, i frymëzuar nga ISIS

Sayfullo Saipov u radikalizua përmes internetit

Historia amerikane e autorit të sulmit të Nju Jorkut fillon në vitin 2010, si ajo e mijëra emigrantëve të tjerë për ëndrën amerikane. Personi që shkaktoi të paktën 8 të vdekur dhe 11 të plagosur zbriti para 7 vitesh në aeroportin "John Fitzgerald Kennedy" të Nju Jorkut. Sayfullo Saipov vendosi të shpërngulej përgjithmonë nga Tashkenti, kryeqyteti i Uzbekistanit. Ishte vetëm 22 vjeç dhe i papunë. Ndërsa e tij e parë ishte në Ohio, duke vijuar më tej në Florida dhe së fundmi në qytetin Paterson të Nju Xhersit. Fillimi duket të ketë qenë i vështirë për agresorin, pasi fliste vetëm disa fjalë anglisht dhe pëlqente të flinte deri vonë, janë shprehur kështu disa të njohur të Saipov për mediat amerikane. Megjithatë, autori i sulmit gjen punë në Florida si shofer kamioni. Pas shpërnguljes nga Florida, ai i bashkohet kompanisë së taksive "Uber" në Nju Xhersit. Një aktiviste fetare dhe blogere uzbekë me bazë në SHBA tha për "BBC" se Sayfullo Saipov u shndërrua në një person agresiv, pasi u radikalizua nëpërmjet internetit. Sipas blogeres, Saipov nuk ishte i arsimuar mirë dhe nuk kishte dijeni për Kuranin përpara se të arrinte në SHBA. Megjithatë, në këto raste dëshmitë e të njohurve dhe miqve të tij janë gjithmonë të njëjta: "Askush nuk vuri re ndonjë



Autori i sulmit, Sayfullo Saipov

POLICIA

Autoritetet policore gjetën një shënim referuar ISIS-it në kamionin me të cilin u krye sulmi. Në dokumentet e agresorit, agjentët e policisë gjetën "Green Card", lejen e qëndrimit të përhershëm në SHBA, duke bërë autorin rezident të rregullt në SHBA dhe një shënim, ku sulmi adresohet në emër të ISIS.

gjë të çuditshme tek Sayfullo Saipov. Ai ishte një njeri i mirë". Kobijon Matkavor, 37 vjeç, gjithashtu nga Uzbekistani pasi e ka takuar në Florida deklaroi për "New York Times": "Saipov pëlqej-

nte Shtetet e Bashkuara. Ai dukej shumë me fat dhe ishte gjithmonë njeri i lumtur. Edhe pse nuk e njihja në brendësi, ai nuk dukej kurrësi si terrorist". "Ujku i vetmuar" është quajtur

nga guvernatori i Nju Jorkut, autori i sulmit terrorist. Andrew Como thanë një konferencë për shtyp se Saipov pritet të mbijetojë pas plagëve të marra nga të shtënat e policisë, kështu që hetuesit do të mund të zbardhin shkaqet e ngjarjes. Como shtoi më tej se ky është sulmi i një personi të vetëm dhe nuk e cilësoi si komplot. Guvernatori tha se autori është frymëzuar nga militantët e Shtetit Islamik, por nuk besohet të jetë udhëzuar drejtpërdrejt nga ata.

Autoritetet policore gjetën një shënim referuar ISIS-it në kamionin me të cilin u krye sulmi. Në dokumentet e agresorit, agjentët e policisë gjetën "Green Card", lejen e qëndrimit të përhershëm në SHBA, duke bërë autorin rezident të rregullt në SHBA dhe një shënim, ku sulmi adresohet në emër të ISIS. Burime të tjera thonë se Saipov bërtiti "Allahu Akbar" gjatë momentit të sulmit. Kohët e fundit duket se sulmet terroriste po behen me kamionë dhe automjete të rënda, ku disa vende janë goditur nga agresione të tilla në mënyrë të ngjashme. Në Nicë të Francës, gjatë një feste një tunizian shkaktoi 86 të vdekur dhe qindra të plagosur me kamionin e tij. Në Berlin, ISIS merr përsipër një sulm të një tjetër tunizian, i cili shkaktoi 12 viktima dhe dhjetëra të plagosur me një kamion të vjedhur.



Presidenti amerikan, Donald Trump

Trump: Do t'i kërkoj kongresit t'i japë fund Lotarisë Amerikane

Duke e konsideruar të dyshuarin për sulmin terror ist në një Nju Jork si "një kafshë", presidenti amerikan, Donald Trump tha të mërkurën se do t'i kërkojë kongresit t'i japë fund programit të Lotarisë Amerikane për emigracionin. Turmp "fajësoi" këtë program për lejimin e Sayfullo Saipov të hynte në Shtetet e Bashkuara. "Unë jam duke filluar procesin e ndërprerjes së programit të lotarisë së diversitetit", tha Trump në një mbledhje të kabinetit. Unë do t'i kërkoj kongresit që të fillojë menjëherë punën për të hequr qafe këtë program, diversitetin si dhe lotarinë e diversitetit. Lotaria e shumëllojshmërisë. Nuk ka qenë diçka e mirë dhe ne jemi kundër". Trump tha se administrata e tij do të kërkonte t'i jepte fund asaj që ai e quajti "emigracionin zinxhir" dhe insistoi për një "një program meritur, ku njerëzit hyjnë në vendin tonë në bazë të meritës". Kommentet e Trump u bënë gjatë një takimi në Shtëpinë e Bardhë, ku deklaroi se do të vlerësonte dërgimin e Saipov në qendrën e ndalimit ushtarak në Gjirin e Guantanamo, Kubë, ndërsa ishte në pritje të gjyqimit. Saipov dyshohet si autori që me anë të një kamioni të marrë me qira, vrau tetë persona në Manhattanin e poshtëm. Lotaria Amerikane hyri në fuqi në vitin 1995. Programi jep rreth 50 mijë viza çdo vit, kryesisht nga vendet ku emigrantët në SHBA janë të nënperfaqësuar dhe zakonisht "të bardhët".

Grabitën argjendarinë në Maltë e plagosën një polic, në kërkim një tjetër shqiptar

Pas grabitjes së një argjendarie në qytetin Tigne të Maltës muajin e kaluar, policia vendose është vënë në kërkim të një tjetër shqiptari si të përfshirë në ngjarje. Shtetasi 26-vjeçar, Bektash Muka, është ai që po kërkohet nga policia malteze prej gati një muaji. Të dielën e kaluar një tjetër shqiptar doli para gjykatës në lidhje me grabitjen e "Diamonds International" dhe tentativën e vrasjes së dy policëve gjatë arrestimit të tij. Ai ishte Daniel Muka, 22 vjeç, i cili mori pjesë në grabitjen e bizhuterive, ku mbeti i plagosur dhe një oficer i sigurisë. Edhe pse Daniel Muka tha se ishte i pafajshëm, gjykata vendosi ta lërë në burg dhe urdhëroi ngrijen e pasurisë së tij teksa Bektash Muka është në kërkim.

Carles Puigdemont rrezikon 30 vite burgim

Lideri i shkarkuar i Katalonjës nuk do të kthehet në Spanjë

SPANJË - Pavarësisht kërkesës së prokurorisë, ish-Presidenti i Katalonjës, Carles Puigdemont, nuk do të kthehet në Spanjë. Vendimi është konfirmuar nga avokati i liderit të shkarkuar katalanas, i cili deklaroi se klientit të tij i mungon garancia e një procesi të rregullt ligjor. Tashmë mbetet të shihet nëse prokurorët do të kërkojnë ekstradimin e Carles Puigdemont. Lideri i shkarkuar i Katalonjës, Carles Puigdemont, nuk

do të kthehet në Spanjë për t'u përgjigjur akuzave që rëndojnë ndaj tij nga prokuroria. Lajmi është përcjellë nga avokati belg i ish-presidentit, Pol Bekart, i cili tha se Puigdemont duhet të qëndrojë në Belgjikë dhe të merrë në pyetje në këtë vend, për shkak të mungesës së garancisë së një procesi të rregullt ligjor. Mbi ish-presidentin dhe 13 zyrtarë të tjerë të lartë rëndojnë një sërë akuzash, përfshirë rebelimin ndaj autoriteteve qendrore të Spanjës. Ai u thirr në një

seancë pyetjesh ditën e mërkurë, por refuzoi që të merrte pjesë. Tashmë mbetet të shihet nëse prokurorët do të lëshojnë një urdhër arresti për Carles Puigdemont. Përfaqësuesi ligjor i ish-presidentit ka deklaruar gjithashtu se edhe në rast të një kërkesë të tillë, ata janë të përgatitur për të kundërshtuar ekstradimin. Kryeprokurori i Spanjës bëri të ditur akuzat që rëndojnë mbi liderin e shkarkuar katalanas, ndërsa në rast se akuzat do të vërtetohen,



Lideri i shkarkuar i Katalonjës, Carles Puigdemont

Carles Puigdemont rrezikon deri në një maksimum prej 30 vitesh burgim. Ndërkohë, mbetet të shihet se çfarë masash do të ndërmerren ndaj zyrtarëve të tjerë. Puigdemont ndodhet në Belgjikë që prej ditës

së hënë. Në prononcimin e tij për mediat, ai u shpreh se nuk ka udhëtuar në Bruksel për azil politik, por për të informuar liderët europianë mbi atë që po ndodh në rajonin e Katalonjës.

Tenton t'i shpëtojë policisë, kapet në Igumenicë 21-vjeçari shqiptar me 5 kg marijuanë

IGUMENICË - Një tjetër sasi droge është kapur në Igumenicë pasditën e sotme, pas 10 kilogramëve marijuanë që u sekuestruan nga policia greke paraditen e sotme. Në aksionin e pasditës, policia e vendit fqinj është vënë në ndjekje të një automjeti, i cili vinte nga kufiri i gjelbër, por nuk i është bindur urdhrit të policisë në Filat për të ndaluar. Pas disa minutave ndjekjeje, policia ka arritur të ndalojë mjetin dhe nga kontrolli ka rezultuar se në makinë fshihej një sasi prej 5 kilogramë marijuanë. Sakaq, në pranga është vënë drejtuesi i mjetit, 21 vjeç dhe po punohet për zbardhjen e plotë të rastit.

TRASHËGIMTARËT PËR KËSTIN E DYTË

ISHI I DUTË JARI POLITIK				TRASHËGIMTARËT E NIVELIT I			TRASHËGIMTARËT E NIVELIT II			DOKUMENTAT						
NR. DOSJES	EMER	MBIEMER	VKM NR.	EMER	ATESIA	MBIEMER	EMER	ATESIA	MBIEMER	KOPJE TE LETER NJOFTIM	NUMER PERSONAL LOGARIT BANKARE	CERTIFIKATE VDEKJE	CERTIFIKATE TRINGJIT FAMILJAR	DESHIMI TRASHGIMTAR	PROKURE	
KËSTI I DYTË																
16751	Rasim	Mandia	509	Jusuf Jusuf		Dollaku						V	V	V		
				Fitnete												
							Sulejman	Muharrem	Dollaku	V					P	
							Ramazan	Muharrem	Dollaku	V					P	
							Rahsim	Muharrem	Dollaku	V					P	
							Fatmir	Muharrem	Dollaku	V	V				P	
19538	Etem	Zejnati	61	Shamet								V	V	V		
				Ali	Shamet	Zejnati						V	V	V		
						Kristo	Bajram	Ali	Zejnati			V	V	V		
							Neriman	Ali	Xhaferaj	V	V					
							Feim	Ali	Zejnati	V	V					
							Sovjet	Ali	Zejnati	V	V					
							Shamet	Ali	Zejnati	V	V					
							Sabri	Ali	Zejnati	V	V					
							Ylli	Ali	Zejnati	V	V					
							Florentina	Ali	Zejnati	X	X					
				Beqo	Shamet	Zejnati						V	V	V		
							Hajdar	Beqo	Zejnati			V	V	V		
							Lalo	Beqo	Zejnati			V	V	V		
							Enver	Beqo	Zejnati	V	V					
							Gezim	(Gligor) Beqo	Zejnati	V	V					
				Lutife	Shamet	Zejnati (Bazati)						V	V	V		
							Galip	Mazo	Bazati			V	V	V		
							Nedim	Mazo	Bazati			V	V	V		
							Sadika	Mazo	Meçe			V	V	V		
							Sadife	Mazo	Meçe			V	V	V		
							Dilfo	Mazo	Bazati	V	V					
							Kano	Mazo	Bazati	V	V					
				Selfo	Shamet	Zejnati						V neg		V		
							Arta	Selfo	Ballaci	V	V					
							Sami	Selfo	Zejnati			V		V		
							Henë	Selfo	Zejnati	V	V					
21577	Pamajot	Kuruti	502	Kostandri	Pamajot	Kuruti						V	V	V		
												V	V	V		
							Gligeria	Kostandi	Llapas	V					P	
							Andonika	Kostandi	Kollçaku	V	V				V	
							Spiro	Kostandi	Kuruti			V				
9654	Shyqiri	Gruda		Sadik								V	V	V		
				Makbala	Gani	Gruda						V	V	V		
				Kimete	Sadik	Haxhia								ZV	PI	
							Mehmet	Shajup	Haxhia	V						
							Nysret	Shajup	Haxhia	V	V				ZV	
				Sadete	Sadik	Dibra								V		
							Sami	Handi	Dibra	V	V					
							Muharrem	Handi	Dibra	V	V					
							Mid-hat	Handi	Dibra	V	V			V	ZV	
				Adile	Sadik	Qehaja								V	V	
							Hyrije	Teufik	Tepeleja	V	V					
							Agime	Teufik	Bushutash	V	V					
							Mehdi	Teufik	Qehaja	V	V				P	
							Saeta	Ramiz	Haxhia	V	V				VI	
21557	Sadik	Gruda		Osmun								V	V	V		
				Kimete	Sadik	Haxhia						V	V	ZV		
							Mehmet	Shajup	Haxhia	V					P	
							Nysret	Shajup	Haxhia	V	V				V	
				Sadete	Sadik	Dibra						V	V	ZV		
							Sami	Handi	Dibra	V	V					
							Muharrem	Handi	Dibra	V	V					
							Mid-hat	Handi	Dibra	V	V			V	ZV	
				Adile	Sadik	Qehaja								V	V	
							Hyrije	Teufik	Tepeleja	V	V				VI	
							Agime	Teufik	Bushutash	V	V					
							Mehdi	Teufik	Qehaja	V	V				PI	
				Shyqiri	Sadik	Gruda						V	V	ZV		
20833	Zenel	Lita	186	Have	Nenë	Lita						V	V	V		
				Harishe	Zenel	Lita						X	X	X		
							Rukije	Abdyf	Uka	V					P	
							Gjyfishahë	Abdyf	Gjorllaku	V					P	
							Xhemle	Abdyf	Sheli	V					P	
							Kujume	Abdyf	Shehu	V					P	
							Florentin	Abdyf	Daku	V					P	
							Hatedin	Abdyf	Ahmati	V					P	
							Safidije	Abdyf	Ndreu	V					P	
							Nurish	Abdyf	Ahmati	V	V				V	
							Elez	Zenel	Lita	X	X					
							Sahit	Zenel	Lita	X	X					
							Hysni (Hysni)	Zenel	Lita	V	V					
							Rozhbi	Zenel	Lita	X	X					
							Mine	Zenel	Lita	X	X					
							Fildharje (Fildharje)	Zenel	Lita	V	V					
							Ali	Zenel	Lita	V	V					
2093	Aqif	Koka	509	Ali								V	V	V		
				Abdulla	Ali	Koka						V	V	V		
				Sadik	Ali	Koka						V	V	ZV		
							Abdulla	Sadik	Koka	V	V					
							Xhevalir	Sadik	Koka	V	V					
							Roshap	Sadik	Koka	V	V					
							Ynuje	Sadik	Karhosa	V	V					
15668	Cubel	Arusha	509	Din								V	V neg	V		
				Beqir		Schivraada						V	V			
12826	Demash	Hoxhaj	691	Musli								V	V	V		
				Demash		Hoxhaj						V	V			
15728	Taqi	Llazo	390	Pec								V	V	V		
				Jorgji	Pashk	Uzo						V	V			
				Llanbrin	Taqi	Koçl						V	V			
				Ermitra	Taqi	Vito						V	V			
				Momka	Taqi	Beci						V	V			

ISHI I DUTË JARI POLITIK				TRASHËGIMTARËT E NIVELIT I			TRASHËGIMTARËT E NIVELIT II			DOKUMENTAT						
NR. DOSJES	EMER	MBIEMER	VKM NR.	EMER	ATESIA	MBIEMER	EMER	ATESIA	MBIEMER	KOPJE TE LETER NJOFTIM	NUMER PERSONAL LOGARIT BANKARE	CERTIFIKATE VDEKJE	CERTIFIKATE TRINGJIT FAMILJAR	DESHIMI TRASHGIMTAR	PROKURE	
20883	Maliq	Sallianji	457	Dile	Maliq	Bazeli						V	V neg	V		
							Xhelal	Selami	Bazeli	V	V					
							Abaz	Selami	Bazeli	V	V					
				(Lima)	Liman	Maliq	Zaim					V	V			
					Sose	Maliq	Cake					V	V	V		
							Bijar	Qemal	Cake	V	V					
							Ajdine	Maliq	Zluti	V	V					
							Pashako	Maliq	Krasniqi	V	V					
							Aferdita	Maliq	Myrtaraga	V	V					
							Shpetimare	Maliq	Alimadhi	V	V				P	
							Feim	Maliq	Sallianji	V	V					
							Ali	Maliq	Sallianji	V	V		V	V	V	
									Gerarda	Ali	Sallianji	V	V			
									Gazmend	Feim	Sallianji	V	V		V	
2171	Filip	Vuka	509	Zef	Filip	Filipi						V	V	V		
				Marrije	Filip	Zadhi						V	V	V	PI	
				Drande	Filip	Pronoka						V	V	V		
</																

Reagojnë këshilltarët e majtë e të qendrës: Absurditet rritja e tarifës, rëndon qytetarët

Rritet taksa e pastrimit në Shkodër, nga 4500 lekë arrin në 52.500 lekë

Bashkia: Shkak rritja e depozitimit të mbetjeve nga landfilli i Bushatit, nuk e përballojmë shpenzimin shtesë



Ishte në kërkim për tentativë vrasjeje e vjedhjeje, kapet në

Kakavijë 24-vjeçari

GJIROKASTËR - Një 24-vjeçar, i cili ishte shpallur në kërkim për disa vepra penale është arrestuar dy ditë më parë në Kakavijë. Bëhet fjalë për Denis Imerin, i cili akuzohet për veprat penale: "Prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike", "Vjedhje e kryer në bashkëpunim" dhe "Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit". Me 31 tetor, në Pikën e Kalimit Kufitar Kakavijë, në hyrje të Republikës së Shqipërisë u paraqiti (deportiv) Denis Imeri, banues në Memaliaj. Pas intervistimit dhe verifikimeve të bëra nga punonjësit e policisë në sistemin "TIMS", shtetasi Imeri rezultoi se është person në kërkim, pasi gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin penal nr.224, datë 28.04.2017, ka caktuar masën e sigurisë 'Arrest me burg' për veprat penale Prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike', 'Vjedhje e kryer në bashkëpunim' dhe 'Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit'. Gjithashtu, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendim nr.932A, datë 05.05.2017, ka caktuar masën e sigurisë 'Arrest me burg' për veprat penale: 'Vrasje me dashje e mbetur në tentativë' dhe 'Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municionit', thuhet në njoftimin e policisë.

Senad Nikshiqi
SHKODËR

Qytetarët e Shkodrës do të paguajnë 4500 lekë të vjetër më shumë për tarifën e pastrimit. Dy ditë më parë, Këshilli Bashkiak i Shkodrës miratoi rritjen e kësaj tarife nga 48 mijë lekë të vjetër që ishte, në 52 mijë e 500 lekë të vjetër. "Bashkia Shkodër depoziton mbetjet në landfillin e Bushatit. Landfilli nga 3800 lekë të vjetër që ishte çmimi i depozitimit, e rriti në 10 mijë lekë të vjetër për ton. Ngritja e tarifës së pastrimit erdhi për shkak të rritjes që bëri landfilli", tha gjatë mbledhjes së radhës, nënkryetari i bashkisë së qytetit verior, Dritan Meta. Vendimi i marrë do të rëndojë në xhepat e qytetarëve, ndërkohë që bashkia justifikohet se nuk mundet ta përballojë këtë shpenzim shtesë. Rritja e tarifës së pastrimit sollli debate në këshillin bashkiak, pasi këshilltarët e majtë dhe të qendrës nuk e pranuan.

DEBATET NË KËSHILLIN BASHKIAK

"Përse vendosët vetëm për të rritur tarifën për depozitimin në landfillin e Bushatit dhe nuk përmirësoni shërbimin në qytet? Si mund t'u thonit qytetarëve që është rritur tarifa, ndërsa nuk ka përmirësim të shërbimit për ju. Kjo është e papranueshme dhe nuk mund të tolerohet. Duhet që të gjeni forma të tjera", - tha këshilltari e PS-së, Mirela Mataj. Në lidhje me rritjen e tarifës ka reaguar edhe Ali Tula, këshilltar i PS-së. "A është e parë e udhës që meqë landfilli e ka rritur çmimin në mënyrë të njëanshme, siç po thonë ju dhe meqë ka edhe një kontratë me bashkisë dhe landfillit, ju të mos e pranoni dhe ta dërgoni çështjen në gjyq? Përse nuk e keni menduar një gjë të tillë, por sa herë kërkojnë ata të landfillit, vini këtu duke kërkuar para. Mendoj të dërgohet në gjyq çështja", u shpreh Tula.



Këshilli Bashkiak i Shkodrës

kanë kontrata me Ujësllësin dhe për rrjedhojë nuk paguajnë as tarifën e pastrimit. Ju në vend që të bëni kontrata me këta apo t'u mblidhni këtyre tarifën, shkoni dhe bëni rritje të çmimit për këta që paguajnë rregullisht. Kjo është absurde dhe e papranueshme, mjafton që gjithë qytetarëve t'u mblidhni tarifën dhe më pas të ardhurat do të jenë aq të mëdha sa për të përballuar edhe depozitimin në landfill, por edhe për të siguruar vetë bashkia të ardhura nga kjo. Kjo është një mungesë menaxhimi dhe paaftësi që e

shfaqni qartazi", - pohoi Fatlum Nurja, këshilltar i FRD. Në emër të grupit të PD-së reagoi këshilltari Bujar Hoti. "Nuk i kuptoj kolegët që kundërshtojnë. Si mund që të mos e rrisim këtë tarifë? Është më mirë që ato para t'i heqim nga investimet apo ta rrisim tarifën me 4500 lekë të vjetër në vit, që është një shumë që mund ta paguajë kushdo. Nuk e kuptoj përse kundërshtojnë apo kërkojnë ta shohin qytetin të papastruar apo edhe pa investime të ndryshme, sepse diku do merrren ato para për të paguar rritjen që ka bërë land-

filli i Bushatit për depozitimin e mbetjeve". E menjëherëshme ka qenë përgjigja nga të majtët: "Ju nuk mundeni që atë që keni bërë vetë gjithë këto vite, të na e hidhni ne. Bashkia Shkodër është totalisht e paaftë në menaxhim dhe këtë e tregon çdo ditë. Ju keni drejtuar bashkinë gjithë këto vite dhe tani paaftësinë tuaj nuk mund t'ia delegoni opozitës këtu në këshillin bashkiak. Ju keni pasur gjithmonë votat dhe keni bërë si keni dashur të gjitha herët, tani s'mund të na thonë se jemi fajtorë, përkundrazi jeni ju fajtorë. Ne nuk

REAGIMI I FRD

"Kjo është absurde dhe e papranueshme, mjafton që gjithë qytetarëve t'u mblidhni tarifën dhe më pas të ardhurat do të jenë aq të mëdha sa për të përballuar edhe depozitimin në landfill, por edhe për të siguruar vetë bashkia të ardhura nga kjo. Kjo është një mungesë menaxhimi dhe paaftësi që e shfaqni qartazi", - pohoi Fatlum Nurja, këshilltar i FRD.

po themi se nuk duhet pastruar apo nuk duhet investuar, por bashkia duhet të dijë ta menaxhojë situatën dhe jo sa herë landfilli kërkon para, ne t'ia aprovojmë. Kjo nuk është drejtë dhe tregon keqmenaxhimin nga ana juaj", - tha Luan Heta, kryetar i grupit të PS-së në këshill. Pavarësisht debateve, tarifa e pastrimit u miratua me 29 vota pro dhe tashmë qytetarët e Shkodrës do të jenë të detyruar të paguajnë më shumë nga xhepi i tyre, edhe pse shërbimi i pastrimit lë për të dëshiruar, ndërsa nuk ka një përmirësim të këtij shërbimi.

"Miniera siguron 40 mln euro në vit, banorët s'kanë asgjë"

Reportazhi i "Le Iene" për Bulqizën: Fëmijët lënë shkollën për mbledhjen e shitjen e kromit

BULQIZË - Gazetarët e emisionit "Le Iene" kanë ardhur në Shqipëri, ku kanë realizuar një reportazh për kushtet e vështira në të cilat jetojnë banorët në Bulqizë, ndërsa në fokus është varfëria e kësaj zonë. Sipas "Le Iene", fëmijët 10-13 vjeçarë lënë shkollën për të mbledhur krom dhe për të siguruar bukën e gojës. Frigoriferët bosh, infrastrukturura që lë për të dëshiruar dhe fëmijët në kërkim të kromit janë ato që italianëve u bëjnë më së shumti përshtypje. E sigurisht, edhe fakti që vetëm nga miniera e Bulqizës nxirren çdo vit rreth 120 mijë tonë krom që kapin shifrën e 40 milionë eurove, por banorët e

kësaj zone s'risin jetojnë në skamje. "Fëmijët që po shikoni nuk janë duke luajtur, ata punojnë që të ndihmojnë familjet e tyre. Ata kërkojnë krom. Janë fëmijë të moshës 10 deri në 13 vjeç dhe në vend që të jenë duke studiuar si të gjithë moshatarët e tyre, ata e kalojnë kohën në këtë mënyrë". Këto janë fjalët e para të gazetares italiane për reportazhin e realizuar në qytetin e Bulqizës. "Të gjithë banorët e Bulqizës punojnë me kromin. Kjo grua është nënë e dy fëmijëve që punon në mbledhjen e kromit. Ajo na tregon kushtet në të cilat jetojnë. Shtëpia është gati duke rënë dhe ajo mezi ia del të ushqejë fëmijët. E vetmja gjë që ka në frigorifer janë disa bidonë ujë, pasi uji vjen

vetëm 2 orë në ditë dhe disa perime të konservuara. Gesti në vend që të shkojë në shkollë, mbledh krom", vijon më tej rrëfimi. Duke u ndalur te familjet dhe frigoriferët bosh të tyre, gazetarja italiane ndalet për darkë në një prej tyre, madje ka gatuar për ta. **FËMIJËT**
Timi tregon: "Unë kur të rritem dua të bëhem si babi. Ai i bën të gjitha, murator, elektrikist. Ai do lumturohet shumë nëse bëhem si ai, e kam ëndërr. Në këtë qytet nuk ka shumë gjëra për të bërë, por ka edhe fëmijë që nuk shkojnë për krom. Atyre nuk u tregoi se shkojë për krom, por për të kaluar kohën. Po ta dinin do më thoshin 'i ky s'ka bukë për të ngrënë'. Timi

NI LAVORATORI CHE AIUTANO LA FAMIGLIA



Gazetarja e emisionit "Le Iene", në Bulqizë

është i lodhur, ndaj e lemë të shkojë për të fjetur, sepse nesër e pret ditë e rëndë. Është ora 7:30 dhe Timi duhet të zgjohet, prindërit kanë shkuar në punë dhe për mëngjesin e tij mendon e motra, Mia. Vjen Blero dhe së bashku vendosin në cillin mal të shkojnë për të mbledhur krom. Ende pa mbaruar së ngrënë, veshin këpucët, marrin kovat dhe

shkojnë të thërrasin mikun e tyre, Gestin. Ai vonon pak, por në fund vjen dhe djemtet nisen drejt malit. Janë fëmijë dhe e kalojnë ditën në kërkim të gurëve që shkëlqejnë më shumë. Duart e kërkim të kromit. Duart e kërkim fëmijëve tregojnë punën që bëjnë këtu çdo ditë. Kur kovat nuk kanë më vend, ata e marrin kromin në bluzë.

Vëzhgim i hollësishëm i Kongresit të 19 të Partisë Komuniste të Kinës

Marrëdhëniet politike dhe ekonomike mes Shqipërisë dhe Kinës

Intervistë ekskluzive me ambasadorin e Shqipërisë në Kinë, z. Selim Belortaja

Nga Genc Mlloja

Selim Belortaja, ambasadori i Shqipërisë në Kinë ka qenë vëzhgues i hollësishëm i Kongresit të 19-të të Partisë Komuniste të Kinës. Por, si e ka parë ai këtë ngjarje, cilat janë marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Kinës, ato politike dhe ekonomike...? Në intervistën dhënë për gazetarin Genc Mlloja, ambasadori shqiptar në Kinë tregon gjithçka përtej asaj që duket.

Cilat do të nënvizoni si tipare të veçanta të këtij Kongresi të 19-të të Partisë Komuniste të Kinës?

Ka disa të veçanta: së pari, ky ishte kongresi i shpalosjes së hapur, pa rezervë të fuqisë dhe potencialit të Kinës si shtet, si ekonomi e si model sistemi shoqëror deri dhe si forcë ushtarake. Për shumë e dekada, në planin ndërkombëtar, Kina ka mbajtur një profil të rezervuar pretendimesh lidhur me staturinë e saj dhe fuqinë e saj. Ajo është mjaftuar të kthehet nga vetja, të përveshë mëngët, të kapërcëjë stadin modest të zhvillimit dhe t'u japë zgjidhje problemeve më të ndjeshme në jetën e përditshme. Është përqendruar në reformat e brendshme dhe në mirëqeverisjen, në forcimin e ekonomisë, shkencës, teknologjisë, kulturës pa shumë zhurmë e pa deklarata të forta. Ndryshe ndodhi në këtë kongres. Xi Jinping tashmë i rikonfirmuar Sekretar i Përgjithshëm i PKK e dytë, ka të bëjë me vizionin dhe projektimin e së ardhmes. Ndryshe nga më parë, ky kongres vendosi piketa të mëdha e ambicioze afatgjatë. U pikeuan stacione stadesh zhvillimi të shpejtë jo më brenda 5-vjeçarit, por brenda disa dekadash deri në 2050, me stacion të parë "zhvillimin e një Kine përgjithësisht të begatë" dhe pastaj ndërtimin e një Kine "të epokës së re" me objektiv avancimin e Kinës drejt "qendrës së skenës" që do t'i mundësojë "kontribut më të madh ndaj njerëzimit". Synimi madhor afatgjatë mbetet ripërtëritja e kombit kinez, "në mënyrë që ai të zërë vendin e merituar në familjen e kombeve". Një veçori tjetër është konfirmimi i modelit të "Socializmit me karakteristika kineze", si një model i suksesshëm dhe funksionues i demonstruar qartë në realitetin e zhvillimit të Kinës dhe ruajtja dhe forcimi i tipareve të tij në të ardhmen. Pastërtia morale e udhëheqjes, lufta pa kompromis kundër korrupsionit dhe përkushtimi absolut ndaj interesit e nevojave të popullit të thjeshtë mbetet një tezë themelore e nënvizuar fort

nga kongresi. Ndërsa aspirata për një rol të ri proaktiv të Kinës në skenën globale ishte një tezë që përshkroi gjithë kongresin. Të gjitha këto shoqëruar me një paketë të gjerë direktivash më konkrete.

Dhe ndoshta e veçanta më e spikatur ishte jo thjesht rikonfirmimi i Xi Jinping si Sekretar i Përgjithshëm (këtë askush nuk e vinte në diskutim as brenda as jashtë Kinës), por çimentimi i staturës së tij si lider i veçantë me vizion, cilësi e dimensione të tjera udhëheqëse. Kjo kulmon me vendosjen e referencës mbi "Idetë e Xi Jinping për socializmin me karakteristika kineze për një epokë të re" - në statutin e partisë. Kjo gjë nuk ka ndodhur me kryetarët në detyrë - që nga koha e Kryetarit Mao.

Ajo që na ra në sy nga ndjekja prej larg e kongresit ishte interesi i madh i medias ndërkombëtare. Rrallë kemi parë pamje të tilla, me qindra reporterë që ndjekin çdo gjë me vëmendje të pazakontë.

Kjo ishte një tjetër veçori e këtij eventi që do të ketë jehonë afatgjatë.

Vëmendja e jashtëzakonshme me të cilën u prit dhe u përcoll Kongresi i 19-të i PKK ishte e pritshme. Ajo flet, së paku, për tri-katër gjëra: 1. që Kina edhe nga analistët më skeptikë po shihet tashmë si një vend i fuqishëm me një shtet funksionues dhe qeverisje efektive. 2. se, edhe pse statistikisht raportohet si vend në zhvillim, pranohet nga të gjithë ekonomia kineze është superproduktive, konkurruese dhe sidomos dinamike. 3. se Kina është bërë padyshim një realitet jo vetëm i pranishëm, jo vetëm i rëndësishëm, por në shumë aspekte edhe dominues në skenën globale. Dhe së fundi tregon se lideri dhe Presidenti Xi Jinping është afirmuar tashmë plotësisht jo thjesht si figura më e fuqishme politike, por edhe si udhëheqësi me një personalitet të madh transformativ.

Analiza mediatike ndërkombëtare është përqendruar më shumë në aspektin formal të përdorimit të termave kyçe të kongresit, të shpalosura sidomos në raportin gjithëpërfshirës të presidentit Xi Jinping, si hyrja e Kinës në një "epokë të re", "ripërtëritje e



Ambasadori i Shqipërisë në Kinë, Selim Belortaja

kombit kinez", "sukses i socializmit me karakteristika kineze", ndërtimi i një shoqërie përgjithësisht të begatë", Kina si "fuqi e madhe", "rol qendror" në skenën ndërkombëtare, etj. Por unë mendoj se ato duhen parë në ballafaqim me realitetin e Kinës, potencialit dhe rolit të saj real sot. Dhe në se shihen këstu terminologjia është krejt normale.

Vendin kryesor në kongres, sidoqoftë e zinte raportimi i arritjeve të deritanishme të Kinës sidomos në fushën ekonomike e shoqërore, nga modernizimi teknologjik deri te zbutja e varfërisë. A nuk është kjo një tematikë ekzekutive më shumë se sa partiake?

Besoj, së paku, për ne shqiptarët për shkak të historisë, kjo situatë është krejt e kuptueshme. Partia Komuniste e Kinës nuk është thjesht një forcë ideore, edukuese dhe frymëzuese. Ajo është edhe motori edhe sistemi i drejtimit të shoqërisë kineze. Për një parti me rol të padiskutueshëm dominues në jetën e Kinës, në politikën zhvillimore të saj dhe në fund të fundit në sukseset e lexueshme të saj në shumë aspekte, është vështirë që raportimi dhe analiza e partisë të ndahet nga ajo e qeverisjes ekzekutive dhe arritjeve.

Kjo shkrimje duket qartë qysh nga titulli i raportit të Xi Jinping: "Garantimi i një fitoreje vendimtare në ndërtimin e një shoqërie përgjithësisht të begatë në

çdo aspekt dhe përpjekja për triumfin e socializmit me karakteristika kineze për një epokë të re".

Cilat janë disa nga arritjet kryesore të Kinës së sotme që u evidentuan nga kongresi?

Për këtë flasin më mirë shifrat. Një vend që edhe mes krizës globale arrin të ruajë ritmin 6-7% të rritjes ekonomike, me GDP që dyfishohet çdo 10 vjet, që për 5 vjet rresht ka hapur 13 milionë vende pune në vit (urban jobs), me 60 milionë njerëz të nxjerrë nga varfëria (linja e varfërisë së sipas standardit të Kinës) në 5 vjet.

Me 300 milionë njerëz të shndërruar tashmë në "shtrës e mesme", duke garantuar një treg të brendshëm kolosal, me aftësi eksporti të jashtëzakonshme e dominim të disa tregjeve, me burime natyrore e kapacitete njerëzore të pafund, nuk ka si të mos imponojë edhe vëmendje dhe respekt të posaçëm ndërkombëtar.

Nga ana tjetër, duket që rezultatet përcillen mjaft mirë te çdo individ dhe qytetari kinez po ndjen epërsinë e rritjes, zhvillimit të shpejtë dhe si rezultat, punësimin dhe të ardhurave, po ndjen epërsinë e shërbimeve publike - që nga siguri mi shëndetësor e pagesa komode kudo nëpërmjet celularit e deri te "shared services", si mjetet e larmishme të transportit me zgjedhje individuale.

A është çdo gjë rozë në Kinë, dhe sa e hapur është

udhëheqja e atij vendi i'i evidentojë problemet që shqetësojnë segmente të gjëra të një popullsisë prej 1.4 miliardë banorësh?

Sigurisht që vështrimet, vlerësimet dhe interpretimet ndërkombëtare janë të ndryshme. Sigurisht ka probleme të trashëguara e të zhvillimit. Por interesante është se vetë udhëheqja kineze në raport me problemat pranon të jetë mjaft realiste. Ajo nuk thotë se Kina nuk ka probleme. Përkundrazi udhëheqja pranon se edhe në bazën teorike nevojiten ndryshime. Një ndryshim i tillë ishte p.sh. ai mbi identifikimin e kontradiktës themelore në Kinën e sotme dhe nevojën për zhvillim të balancuar. Edhe më parë, vetë Xi Jinping, në disa fjalime të tij, përfshi atë në Seattle të ShBA vitin e kaluar i ka bërë prezent këto mungesa ekonomike e sociale që ende vazhdojnë të jenë prioritet. Edhe të ardhmen presidenti Xi nuk e pikëtoi aspak si një fushë me lule.

Ai tha këto janë objektivat dhe ambicia jonë, por tha edhe se arritja e tyre në etapën 2021 dhe 2049 kërkon sakrificë të mëdha, nuk të palodhur nga cilido e sidomos kërkon luftë të pareshur kundër korrupsionit dhe devijimit nga misioni i qeveritarëve, partiakëve dhe drejtuesve.

Përmendët luftën kundër korrupsionit. A ka të dhëna se si luftohet ai në Kinë?

Është për t'u theksuar se

ka transparencë në luftën pa kompromis kundër korrupsionit, e forcuar dukshëm nën udhëheqjen e Presidentit Xi dhe e hapur për opinionin e brendshëm dhe të huaj. Bie në sy se gjërat thuheshin konkretisht.

Burime të ndryshme thonë se janë ndëshkuar mbi 1 milion zyrtarë të vegjël e të mëdhenj, se edhe nga Komiteti Qendror i PKK janë arrestuar 18 vetë ose 9% e gjithë KQ, e dënuar shumë ashpër deri tani 6 prej tyre. Raporti i Xi garanton se në luftën antikorrupsion nuk do të kursehet askush dhe se do të goditen pa mëshirë si "tigrat", ashtu dhe "mizat" dhe "dheprapat". Kjo luftë shihet si një parakusht i domosdoshëm për të garantuar qeverisje të moralshme, të dedikuar dhe arritjen e objektivave shumë të vështira e ambicioze.

Si Shqipëri, si duhet ta shikojmë këtë fazë të re në të cilën po hyj Kina sa i përket bashkëpunimit ekonomik kur dihet tashmë potenciali i madh i saj, por edhe 'agresiviteti' për të investuar në projekte të rëndësishme në Europë, sidomos në atë Lindore, por edhe në Ballkanin Perëndimor?

Mendoj se ne, shteti e qeveria shqiptare, duhet ta ndjekim me vëmendje këtë etapë të re të zhvillimit në Kinë dhe programin e udhëheqjes së re të dalë nga Kongresi i 19-të.

Kemi bërë shumë mirë që u jemi bashkuar platformave të rëndësishme të iniciuara nga Kina si "Një brez, një rrugë" dhe "16 + 1". Por duhet dhe shumë punë konkrete. As nismat e mësipërme, as bashkëpunimi tradicional dypalësh nuk ofrojnë më "dhurata".

Përfitim për tyre mund të vijë vetëm përmes modelit "win-win" - pra nëpërmjet planbizneseve e projekteve me interes të ndërsjellë. Jo thjeshtë për dy qeveritë, por edhe për operatorët e biznesit konkret.

Duhet ta marrim shumë seriozisht sidomos paraqitjen e paketave e projekteve të posaçme të përshtatshme për bashkëpunimin Shqipëri-Kinë. Kjo sigurisht nuk është një punë e lehtë, sepse Shqipëria nuk është e "vendi i parapërzgjedhur". Ne duhet të konkurrojmë ashpër me të tjerët, me fqinjët tanë e përtej.

EKSPOZITA

"Kotësia e dallimeve të vogla", shuplakë klasave shoqërore

Grayson Perry është thesar kombëtar. Karriera e tij nisi si një "poçar transvestit" e kontrovers, por ai tanimë është artist fitues i Turner-it; autor dokumentarësh që ka fituar BAFTA e një burrë dhe një baba të përkushtuar". Kështu e prezanton "The Vogue" në Britani, një prej artistëve më në zë artit pamor në Britaninë e Madhe. Çelët sot në Galerinë Kombëtare të Arteve, ekspozita "Kotësia e dallimeve të vogla" të artistit britanik Grayson Perry. Ekspozita përbëhet nga 6 tapiceri, 8 gravura origjinale të punës së William Hogarth, 20 riprodhime dhe 3 dokumentarë të krijuar nga udhëtimet e Perry-t në rajone të ndryshme në Angli. Qëllimi i ekspozitës së Perry-t është vëzhgimi, njohja dhe kuptimi i klasave shoqërore britanike dhe shija që lidhet me to. Pikturat e tij në tapiceri kanë në qendër jetën e Tim Rakewell, i cili lind në klasën punëtore, pasurohet dhe bëhet pjesë e klasës së mesme, por nuk arrin dot të futet në klasën e lartë të shoqërisë dhe në fund vdes i pasur në një aksident automobilistik. Në konferencën për shtyp, kuratori i ekspozitës në Shqipëri, Rubens Shima, ish-drejtor i GKA-së, sqaroi konceptin artistik, mesazhet dhe moralin që Perry përpjet të transmetojë në punët e tij. "Jam i kënaqur që jam marrë me ekspozitën 'Kotësia e Dallimeve të Vogla', të një prej autorëve më të njohur në Britani të ditëve të sotme. Ekspozita zë fill nga një seri dokumentarësh në bashkëpunim me "Channel 4", ku artisti bën një vëzhgim të kujdesshëm mbi klasat shoqërore dhe shijen në Britaninë e Madhe. Më pas shënimet, impresionet, vëzhgimet, fotografimet që mbajti gjatë këtyre udhëtimeve, vendosi t'i sjellë në formën e një ekspozite duke zgjedhur pikërisht një teknikë shumë të vjetër, njëkohësisht shumë të çmueshme dhe që lidhet me statusin e prestigjit dhe statusin e familjeve të dikurshme aristokratike, që është tapiceria", tha Shima. Sipas tij, në një lloj kuptimi ai donte që vizitat e tij t'i bënte të pavdekshme meqenëse tapiceria në origjinën e saj të her-

Artisti që cilësohet si thesari britanik, me ekspozitë në Galerinë Kombëtare



Grayson Perry
Foto nga Getty Images

Foto nga ekspozita



shme është mbajtur si një lloj media që regjistron ngjarje historike. Pra, duke marrë nxitje nga historia e vetë tapicerisë, ai ven-

dosi që vizitën e tij në shtresat e ndryshme të historisë britanike, pra këtë rrëfjë morale të modernitetit ta përjetësonte në tapiceri", nënvizoi Shima. Drejtori i GKA, Artan Shabani e cilësoi si risi këtë ekspozitë. "Jam shumë i nderuar që finalizuam këtë projekt dhe falënderoj 'British Council', që zgjodhi Galerinë Kombëtare për këtë bashkëpunim, duke bërë të mundur të sjellim së bashku artistin Grayson Perry në Shqipëri. Ekspozita është risi jo vetëm për Galerinë Kombëtare, por për të gjithë skenën artit shqiptar. Siç e dini, vjen në Tiranë pasi është hapur në Londër, Turqi, Ukrainë dhe Ballkanin Perëndimor". Shabani shtoi se përveçse na prezanton me një artist shumë të veçantë, ekspozita i bën një skaner klasave shoqërore britanike, përcjell mesazhe dhe hap diskutime jo vetëm në kontekstin e shoqërisë britanike, por në çdo shoqëri. "Përmasa saj, publiku do të mund të përballet me një këndvështrim, ndoshta të pahasur më parë, i pasuruar gjithashtu me elemente autobiografikë dhe satirë", tha Shabani. Drejtuesja e "British Council", Aida Bërzholi vendosi theksin në mesazhet që përcjell arti i Perry-t në këtë ekspozitë. "Puna e Grayson Perry është rreth njerëzve, qenies njerëzore. Nuk ka gjë më interesante se sa të studiohet, të debatohet mbi natyrën njerëzore. Ky është parimi që e bën interesante ekspozitën për publikun. Për ne si 'British Council', ky parim përbën edhe thelbin e punës, pasi ne përpigemi të nxisim debatin, të mblidhemi së bashku, të diskutojmë dhe të ndajmë këndvështrime. Për gjatë kohës që ekspozita do të jetë e hapur, do të organizohen disa evente, sesione edukimi, diskutime dhe debate", u shpreh Bërzholi. Ekspozita do të qëndrojë e hapur deri më 5 dhjetor 2017.

LIBRI



PREÇ ZOGAJ "NË DASHURI", BOTON 101 POEZI

Të premtën promovohet në Tiranë vëllimi poetik i Preç Zogajit, me 101 poezi dashurie, botim i shtëpisë botuese "Uet Press". Përveç fjalëve të rastit, do të lexohen disa poezi nga aktore të Teatrit Kombëtar. Gëzim Basha shkruan në parathënie se përzgjedhja e librit "In Love", si thuajse krejt poezia e Preç Zogajit, është një koleksion odesh moderne, ku klasi teknik, efektet poetike dhe finesa gjuhësore ofrojnë diagramë e ndeshmërive të një mendjeje reflektive, që e sheh botën me sy lirik. Sipas tij, për shkak se fjalori arkaik i termave stilistike të kritikës sonë letrare, ende e merr oden si model të ngurtë në duart e Pindarit: strofë, antistrofë, epode apo si kallëp metalik klasikist të trashëguria nga Horaci, përcaktimi "ode moderne" mund të tingëllojë paska oksimoronik. Ai shton se odet e Zogajit për dashurinë të kujtojnë odet e Pablo Nerudës, ato i prin synimi për të celebruar atë që kritikizmi i ri e quan 'the significance of the insignificant' apo rëndësinë e gjërave, në dukje, të parëndësishme. "Ato e kërkojnë formën si struktura të hapura, janë lëvizje drejt formës, por pa të bërë formale. Ndonëse plot melankoli, ato ndahen qartë prej elegjisë, por kjo ndarje nuk është veçse një membranë transparente, përmes së cilës zhanret shihen dhe ndahen", shton Basha.

ARTAN FUGA "PAJTOHET" ME AKADEMINË E SHKENCAVE



Asamblesë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Akademik Salvador Bushati - anëtar i Asam-

blesë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Akademike Aurela Anastasi - anëtare e Asamblesë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Akademik Artan Fuga - anëtar i Asamblesë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Akademik Apollon Baçe - anëtar i Asamblesë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademik Beqir Meta - anëtar i Asamblesë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

105-VJETORI I SHPALLJES SË PAVARËSISË

"ARMË TË MJESHTËRVE SHQIPTARË" NË EKSPOZITË

Muzeu Historik Kombëtar hap më 3 nëntor 2017 ekspozitën me titull "Armë të mjeshtërve shqiptarë". Ajo organizohet në kuadër të 105-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Ekspozita përmban 47 objekte: 21 kobure, 8 pushkë, 10 vezme, 2 harbi dhe 6 jataganë. Armët ilustrohen edhe me fotografi, me anën e të cilave pasqyrohet puna artistike e armëtarëve shqiptarë. Zbukurimet e armëve janë bërë me teknikën e filligranit. Kjo vërterton se shqiptarët ishin mjeshtër në punimin dhe zbukurimin e armëve. Armët e tyre ishin të punuara me argjend, por edhe të lara me ar. Në pavijonet e Muzeut Historik Kombëtar janë ekspozuar pushkë, kobure, vezme, harbi dhe jataganë. Ekspozita "Armë të mjeshtërve shqiptarë" do të jetë e hapur në hollin kryesor të Muzeut Historik Kombëtar nga data 3 nëntor deri më 13 nëntor 2017.

Akademiku Artan Fuga është "pajtuar" me Akademinë e Shkencave pas debateve që ngjallin për të. Kur ajo rrezikon të shkrihet, për shkak të fondeve që me gjasë qeveria do ia presë, Fuga u është bashkuara akademikëve që kërkojnë të mbajnë gjallë. Sipas një njoftimi të Akademisë, me vendim të asamblesë së ASH-së të mbajtur në datën 31 tetor 2017, këtë të enjte mbahet një konferencë për shtyp për informimin e opinionit publik, në orën 13.00 në sallën "Aleks Buda" në Akademinë e Shkencave. Përberja e panelit të konferencës për shtyp është si vijon: Akademik Vasil S. Tole - anëtar i

INTERVISTA

"Në fillim isha vetëm në Shqipëri, sepse refugjatët kosovarë erdhën në aty atë kohë, në prill. Më pas, në gusht 1999 shkova edhe në Kosovë..."

Genevieve Colas:

Si e mbaj mend Shqipërinë e 1999-ës dhe luftën e Kosovës

| Rrëfimi i francezes që koordinon 25 organizata: Ka shqiptarë minorenë në Francë të ekspozuar dhe kaq vulnerabël ndaj shfrytëzimit dhe trafikimit

Fatmira Nikolli

Pat ardhur për herë të parë në Shqipëri kur kriza te refugjatët e Kosovës, kishte nevojë për ndihmë e asistencë nga jashtë. Genevieve Colas e kujton ende atë kohë, kur qytetet e verit patën hapur dyert për të pritur të ikurit nga lufta. Pothuaj 20 vjet më vonë, gjen një Shqipëri tjetër, kur kriza nuk është më ajo, por nevoja për ndihmë e asistencë është sërish. Rrëfimi i saj, flet për Shqipërinë e djeshme e të sotme, kur mes përmirësimeve gjen edhe situata të pandryshuara.

Genevieve Colas punon prej shumë vitesh në Caritas-in francez si përgjegjëse për çështjet e Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe koordinatore e një rrjeti kombëtar prej 25 organizatave joqeveritare në Francë që punojnë së bashku për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore. Si pjesë e grupit ndërmministreral, ku bashkë me rrjetin e NGO punojnë për të zbatuar Strategjinë Kombëtare të qeverisë franceze, e anëtare e platformës së BE për antitrafikun dhe anëtare COATNET-rrjetit të organizatave të krishtera botërore, ajo punon dhe advokon në lidhje me këtë çështje.

- Si e mbani mend vitin 1999 në Shqipëri? Cilat janë kujtimet për Shqipërinë në luftën e Kosovës?

Viti 1999 ishte hera ime e parë në Shqipëri. Ishte muaji prill. Caritas-i francez u angazhua për të mbështetur Caritas-in shqiptar pas luftës së Kosovës. Erdhëm këtu bashkë me kolegë të tjerë dhe punuam në Tiranë. Lezhë dhe qytete të tjera. Në atë kohë lindi dhe një projekt kombëtar me të rinjtë, integruam në Shqipëri Animacionin Social dhe punuam që të zhvillojmë kurrikulat për trajnimin e animatorëve social. Organizimin trajnime me të rinjtë në mënyrë me pasditë ata të rinjtë ishin animatorë për fëmijët në kampet. Në fillim isha vetëm në Shqipëri, sepse refugjatët kosovarë erdhën në Shqipëri atë kohë, në prill, më pas në gusht 1999, shkova edhe në Kosovë me shqiptarë të Kosovës. Me ta organizuam aktivitetet për rindërtimin e jetës atje. Në këtë moment, ne vazhduam të punonim me Caritas-in shqiptar, sepse në pamë që veçanërisht në

Laç, kishte shumë vështirësi, shumë varfëri dhe menduam se Caritas-i shqiptar kishte ndihmuar shumë njerëz nga Kosova gjatë qëndrimit në Shqipëri, por nga ana tjetër situata në Shqipëri ishte kaq e vështirë.

- Ndihma juaj nuk ishte vetëm financiare?

Në ishim pjesë e ndihmave emergjente, si në çdo krizë në botë. Në çdo kohë krize në jemi pjesë e grupit të koordinimit për të ndihmuar njerëzit që mund të jenë me probleme të ndryshme. Ne financuam projekte që janë të fokusuara në zhvillimin njerëzor, drejtpërdrejt në nivelin lokal. Prota-

vetëm në vende të tjera të botës dhe se askush në Francë nuk mund të ishte viktime e trafikimit. Është e rëndësishme të kuptojmë se cilat janë mënyrat e trafikimit. Me 25 NGO e nën drejtimin e Caritas Francë, punuam për të përgatitur një dokument se cilat janë format e trafikimit: trafikimi për qellim shfrytëzimi seksual, shfrytëzimi për punë të detyrueshme, fëmijë të detyruar të lypin, apo fëmijë që iu është premtuar të jenë pjesë e skuadrave sportive, por përfundojnë në rrugë. Kemi bërë një film 15 minuta për këta fëmijë dhe ka shumë njerëz që kur e shohin, thonë: "Ah, po, kemi parë disa njerëz

një art-terapi.

- Ku i prezantoni studentit tuaj dhe librat që tregojnë shumë për viktimat?

I prezantuam në qershor në Kombet e Bashkuara në Gjenevë në Këshillin e të Drejtave të Njeriut, gjate një eventi special mbi trafikimin dhe pornografinë e abuzimin e fëmijëve. Është e rëndësishme të flitet për to, të kuptohet që kjo ndodh kudo.

- Nderkaq, veç trafikimit të fëmijëve, po punohet edhe për identifikimin e viktimit në zonat në konflikt.

Është një punë e bërë nga Caritas-et e disa shteteve si, Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë, Ukrainë, Turqi, Kosovë, Liban, Armeni etj. Kur filluam studimin kishte shumë konflikte. Ideja ishte për të parë situatën e trafikimit në kohë konfliktesh, pse ky trafikim rritet në kohë lufte, cila është forma dhe pamë se çfarë mund të bëjnë Caritas-et për të ndihmuar njerëzit që

janë në këto situata. Ne morëm disa shembuj nga disa vende të ndryshme. Pamë cilat janë kushtet e çdo shteti në kufij, si mund t'i identifikojnë viktimat e trafikimit, kur njerëz nga vendet e krizës kalojnë transit në shumë shtete - si mund të identifikohen e si mund të ndihmohen? Mbas kësaj ne japim disa rekomandime mbi identifikimin dhe mbrojtjen e tyre.

- Si është bashkëpunimi juaj me Caritas-in shqiptar sa i takon trafikimit të qenieve njerëzore?

Ne jemi në Shqipëri këto ditë bashkë me përfaqësues të 12 Caritas-eve nga Europa dhe Mesdheu në kuadër të Ditës Europiane Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore për të punuar në fushën e mbrojtjes së fëmijëve nga trafikimi dhe forcimi i mekanizmeve dhe instrumenteve mbrojtës në nivel institucional dhe social, sepse Caritas-i shqiptar është motor në këtë projekt. Caritas-i sh-

qiptar me mbështetjen e Caritas-it francez koordinon këtë projekt prej 6 vjetësh, që është një vazhdimësi e punës tonë në nivel ndërkombëtar.

- Shqiptarë viktima të trafikimit në Europë, gra shqiptare a fëmijë shqiptarë e që janë trafikuar, a ka? A mundni ju të jepni të dhëna për këtë?

Po, po. Mundem të them, sepse ka shqiptarë. Ka shumë minorenë në Francë aktualisht që janë shqiptarë. Këta janë krejt të ekspozuar dhe kaq vulnerabël ndaj shfrytëzimit dhe trafikimit. Ka shumë vështirësi, sepse disa mund të kthehen në Shqipëri, por Konventa Ndërkombëtare e Fëmijëve në Francë e jo vetëm aty, kërkon që fëmijët që janë në Francë duhet të kenë mbrojtjen e shtetit francez deri në moshën 18 vjeç. Dimë që ka shumë fëmijë që shfrytëzohen ndër të tjera edhe për të lypur, por ndonjëherë ka edhe për shfrytëzim seksual.

- Edhe seksual?

Ah, po. Jo shumica, sepse shumica e të ardhurave në Francë janë nga Nigeria- Afrika, por ka edhe nga Shqipëria.

- Cili është rekomandimi juaj, këshillat tuaja jo për Caritas-in mbase, por për Shqipërinë në këtë rast?

Ne mendojmë se parandalimi është gjëja më e mirë, që mund të bëjmë. Duke punuar shumë në fushën e parandalimit dhe informimit publik rreth fenomenit të trafikimit dhe formave të ndryshme do të ndërgjegjësojmë jo vetëm personat vulnerabël dhe në risk, ata që paguajnë për këtë shërbim (klientët), trafikantët, por dhe institucionet shtetërore që të hartojnë dhe të zbatojnë politika mbrojtëse. Gjithashtu duhet të ketë më shumë mbështetje për familjet, sepse fëmijët janë me shumë të prekur nga ky fenomen. Ne Francë mendojmë se duhet të punojmë me vendet e origjinës, sepse ndonjëherë ka fëmijë që kanë familje, që nuk e dinë situatën e fëmijës atje.



Në foto: Genevieve Colas



jeket kishin në fokus fuqizimin e komunitetit në mënyrë që zgjidhet të vijë nga vete ai, që këto më pas të ndihmojnë njerëz të tjerë. Ka pasur edhe ndihmë materiale, por shumë pak. Më shumë jemi pozicionuar në fuqizim kapacitetesh dhe zhvillimin social.

- Ju kenë lëvizur në vende të ndryshme, në kohë krizash. Si është të jetosh nëpër kriza? Si e përballoni nga ana emocionale?

Kam qenë në Çeçeni, në Ballkan, në Liban- në kufi, është ndryshe kudo, është vështirë kudo, por ajo çfarë është e rëndësishme për mua, është të ndihmoj njerëzit të bëjnë diçka që të mos jenë tërësisht të varur nga situata, tërësisht të mposhtur prej saj.

- Një prej projekteve tuaja, ka të bëjë me trafikimin e fëmijëve. Cila është situata e tyre?

Në fillim ne konstatuam se njerëzit në Francë mendojnë se trafikimi i qenieve njerëzore bëhet

në këto situata". Pas kësaj, ne bëmë një film të dytë që në një farë mënyre tregon se si ne mund t'i ndihmojmë këta fëmijë, që janë viktima trafikimi. Është një ndihmë që ka të bëjë me edukimin kryesisht, riintegrimin e tyre, që më pas të kenë një zanafillë të sigurt jetën. Regjisor i filmit, është një italian që kur ka qenë fëmijë, është grabitur nga mafia italiane dhe është mbajtur për 5 javë e ishte vetëm 14 vjeç. Broshurat dhe librat tanë tregojnë se çfarë duhet të bëjmë me viktimat e trafikimit, se cilat janë problemet specifike. Ata kanë nevojë për ndihmë fizike, psikologjike dhe edukim që të mund të përballojnë vetë jetën, duke nisur edhe me një identitet për ta dhe më pas bashkëpunimi me drejtësinë, duke i bërë ata që të flasin. Ka piktura, përmes të cilave mund të kuptohet gjendja e fëmijëve. Ata nuk kanë besim te askush dhe shpesh historinë e tyre e tregojnë përmes vizatimeve, pra ka

Opinion *i* Ditës

Nga Andon Andoni

(Vijon nga faqja e parë)

... dhe mënyrën e investimit ndaj tyre, kryesisht në zonat rurale, e ku pjesë e grupit ishin e disa të huaj nga Bashkimi Evropian, që pyesnin jo pa habi dhe kureshtje.

Xhamia apo kisha, që ndonjëherë janë vetëm fare pak metra më tej se shkolla, janë të reja dhe fort mirë të pajisura e të mirëmbajtura, kurse shkolla kreyt e kundërta e tyre, e mirëmbajtur keq, pa banja, pa dritë... Gjithçka e lënë në derën e shtetit? Nuk arrijmë ta kuptojmë këtë indiferencë të shqiptarëve për të rindërtuar e mirëmbajtur shkollën, kurse kreyt të kundërtën bëjnë për kishën dhe xhaminë?

M'u kujtua kjo histori këto ditë kur Ministria e Arsimit Sporteve dhe Rinisë, për herë të parë gjatë këtyre gati 30 viteve ka promovuar disa nisma për të afruar komunitetin ndaj shkollës dhe për ta nxjerrë nga indiferentizmi i kahershëm, saqë jo vetëm janë shprehëdhënëse, por në bindjen time, jemi tejet vonë për të vendosur raporte të drejta të këtij komuniteti me institucionet e tilla të besimit dhe dijes, si: shkolla, kisha dhe xhamia.

Projekti "Shkolla Qendër Komunitare" e nisur vite më parë, "Pjesëmarrja e prindërve në hartimin e planeve vjetore të shkollës", si dhe pilotimi i "Shkolla me kohë të plotë studimi dhe dreke falas" për fëmijët janë disa nga arsytet që më bëjnë të besoj se më së fundi, goditja e sjelljes indiferente të shoqërisë ndaj shkollës po troket si dikur në kohët më të vlera të saj.

"Në të gjithë Shqipërinë, - thuhet nga ministria - planet shkollorë do të jenë produkt i një pune të përbashkët mes mësuesve dhe prindërve. Sa më shumë prindërit e mësuesit të jenë bashkë për të ndarë e zhvilluar përgjegjësi të reja, aq më shumë arrijtë e fëmijëve bëhen të dukshme dhe aq më shumë afrimi i qytetarëve pranë detyrës të shkollave lu shërben fëmijëve dhe rrit cilësinë e merituar në arsim".

Mund të ketë edhe dyshime për rrugët dhe mënyrën e ofertimit ndaj këtij prindi, siç kam edhe unë, që druaj se mendimi i çobanit të fshatit tim, Likut, mund t'i sugjerojë ndonjë gjë të vlerë mësues Anilës, në lidhje me planin vjetor të shkollës?! Kjo është një gjë, porse që edhe këta të fundit duhet të shohin ndonjëherë derën e shkollës dhe klasës ku mësojnë fëmijët e tyre, se ndoshta do t'iu duhet të zbrisin nga mali disa nga bimët e rralla për herbariumin e shkollës, është më së paku, një urë komunikimi e munguar kreyt mes palëve. Do rrekemi të deftojmë edhe pak histori, në marrëdhënien e shqiptarit me shkollën, për të kuptuar se sa imediatë është sot gjetja e rrugëve efikase të ofrimit të komunitetit pranë shkollës dhe problematikës së fëmijëve në kohët e reja, për të cilën politikat e ministrisë duhen përsëritur.

Është i njohur fakti që në fillimet e Rilindjes Kombëtare dhe deri në fund të Luftës së Dytë Botërore, shkollat shqiptare u çelen, u ndërnuan, u financuan nga vetë shqiptarët, thuhajse pa ndih-



mën më të vogël qeveritare, madje kjo edhe i pengoi ato.

"Në Elbasan qeveria (Xhon-turke-AA) është detyruar të hapë përsëri shkollën tonë normale, - do shkruante patrioti Dervish Hima në prill të 1912-ës, - por jo me qëllime të mira, por për ta penguar lëvizjen tonë kombëtare. Sa për ne, kemi arritur të mbajmë e të krijojmë një shkollë fillore shqiptare në Elbasan, që frekuentohet prej më se 160 nxënësish. Haxhi Adil beu, ministri i varfër shtetit e Turqisë së re, (ministri i Brendshëm-AA) e vizitoi shkollën tonë. Unë isha i pranishëm, meqë kisha arritur aty po atë ditë nga Cerma. (Cerma çiflig i Dervish Beut që ndodhet 10 kilometra larg Elbasanit) zoti ministër bashkë me shpurën e tij hyri në shkollë, që nuk është veçse një stallë... Në çastin kur ministri dhe shokët e tij të reformës donin të dilnin, një shqiptar i vogël 11-vjeçar u ngrit me mirësjellje të madhe dhe lexoi një fjalim, ku kërkohet një ndihmë për ndërtimin e një shkolle, që ata të mos vazhdonin të qëndronin në stallë. Ministri qeshi me ironi. Ai nuk iu përgjigj fare. Por në mbrëmje unë mësova se do të jepnin 300 lira turke për ndërtimin e shkollës, por që nuk u dhanë kurrë...".

Kjo letër e Dervish Himës flet qartë se nga qeveritë e kohës, anti-shqiptare, as që mund të pritjet gjë. Dhe vetë patriotët shqiptarë e dinin këtë.

"Për themelimin e kësaj shkollë (është fjala për çeljen e shkollës shqipe në Kruajë më 1912-AA) Esat pashë Toptani i Tiranës dha 250 napolona, Fuat beu 100, Abdi beu 100, Refik beu 50, Masar beu 50, Xhelal beu 50, Hamdi beu 50, Jusuf

aga Elezi 100, ndërsa 300 u mblodhën aty-këtu. Popullsia si dhe shumë bejlerë do të ndihmojnë duke dërguar gurë dhe materiale të tjera të dorës së parë".

Siç shihet, komuniteti i kohës ishte i gjallë dhe aktiv ndaj shkollës. Jetonte me të. Merrte frymë me të. Lartësohej dhe përparonte me të. Çështja e shkollimit të fëmijëve ishte jetike. Edhe misionarët e huaj si Kryqi i Kuq Amerikan, austriak Philaeas Kennedy, misionarë çifligë, francezë dhe italianë donin ta bënin prindin pjesë në investimin ndaj shkollës. Në Elbasan synuan të ngrënë shkollën e parë të nivelit të lartë, Carnegiet me këmbënguljen e Çarls Telford Eriksonit sipas modelit të Stambollit, me të vetmin kusht që komuniteti të ofronte së paku tokën për ndërtim falas. Shembuj, kur vetë katundet çelen shkollat anë e kënd vendit, me kontribute tërësisht të tyre, duke kërkuar prej qeverisë vetëm mësuesit, madje ndonjëherë në pamundësi të përmbushjes së saj përdorën edhe hoxhën dhe priftin si mësues të përkohshëm janë pafund. "Shkollën e vashave në Korçë, - pohonte Sevasti Qirjazi, - e mbronin ditë e natë tërë qyteti". Pa dorën e komunitetit, pa të madh e të vogël të ngritur në këmbë, nuk do të kishte shkollë shqipe.

Shkolla kisha dhe xhamia deri në kohën kur shteti komunist shqiptar shtetëzoi çdo gjë, pronë private, zejtarinë, fabrikat, shtypin, tregun dhe prishi kisha e xhamia, patën shkuar dora-dorës të tria. Pastaj gjithçka i takoi shtetit. Babai dhe nëna u tërhoqën nga dyert e shkollës. Barra i ra vetëm mësuesit. Gjersa edhe në kine-

manë e asaj kohe një personazh-fëmijë deklaronte; "i shtetit jam!" Propaganda komuniste i "mbajti larg" prindërit, që kishin për detyrë vetëm të lindnin sa më shumë fëmijë ushtarë për Partinë se pastaj kujdesej shteti, i barabar të për këdo. Motoja se "fëmijën ia kam dorëzuar shkollës dhe mësuesit janë përgjegjës për edukimin e tij", ishte një nga parullat e ditës. Prindi "mbahej i informuar" për fëmijën e tij deri në arë dhe në kantier prej mësuesit, që porositi pa të keq që "t'ia tërhiqte veshin dhe madje ta rrihte nëse nuk mësonte!". Kjo ishte detyrë e tij. Prindi kishte detyrë të ndërtonte dhe mbronte atdheun.

Vitet '90 sollën qasje të re për shkollën, por nëse vetë komuniteti i mësuesve filloi me hapa të shpejta të përshtatje dhe ambientojmë me nevojat dhe pritshmërinë, në shumicën dërmuese prindi mbeti sërish në llogoren e vjetër ku, "përgjegjësi kishte shkolla për edukimin e fëmijës së tij".

Për kujdesin ndaj infrastrukturës, ku mund të kontribuonte edhe ai, prindi as që bëhej fjalë edhe në këto vite. Për inerci të kohës së shkuar, iu kërkua shtetit të bënte gjithçka, edhe shkollën, edhe mirëmbajtjen, edhe menaxhimin. Prindi mbeti sërish shërxhin. Hallet e shumta dhe rropatjet për të gjetur vendet të reja pune, tashmë jashtë planifikimeve të dikurshme e bënë që të vijonte të shkëputte kreyt mendjen nga shkolla ku i mësonin fëmijët.

Ishte fat për shkollën nëse ndonjë nga fëmijët "bindte" babin biznesmen që të ndihmonte për të vënë xhamat e dritareve apo për të riparuar derën e klasës. Por jo në pak rasteve, babai ofrohej pranë

shkollës se e dinte që kjo ndihmesë nuk do t'i shkonte dëm, kur kushtet e reja kishin në themel "kërkesë ofertën". Ata që u interesuan vërtet për shkollën ishin individë që pretendonin se shkolla ishte ndërnuar në tokën e tyre dhe ndodhi që t'i vinin kyçin! Ndërsa sot që të gjithë rezultojnë të jenë roje e sanitarë të shkollave për kompensim të kontributit që patën dhënë! Ka edhe shembuj mbështetës dhe pozitivë nga prindërit, kryesisht në drejtim të rregullimit të mjediseve shkollorë dhe infrastrukturës, por ajo që mendojmë se është vlerë në nismat e fundit të Arsimit është fakti se po ftohet komuniteti që të bëhet pjesë aktive e problematikave të vetë shkollës, të ndjejë frymën e saj, të dijë se çfarë dhe si e organizojnë orën e mësimit fëmijet e tyre në klasë dhe nëpër veprimtaritë jashtëshkollorë. Prindi është gjithçka. Le të kujtoj se shumëkush e ve re që gjimnazistët pinë duhan për shtatë palë qeje në kafene, ku vetëm një tavolinë me tutje ndodhen mësuesit e tyre kreyt të pafuqishëm t'iu kujtojnë se është shkelje e rëndë e rregullores së shkollës, por nëse tek ajo tavolinë e mësuesve do uleshin më shpesh prindërit e tyre, nuk do ty-moste askush!

Ndaj, mendojmë se kontaktet e përditshme të tyre me prindër do jetë një hap në drejtimin e duhur për modernizimin e shkollës. Për të ditur tani jo vetëm ku pikon çatia e vet, por edhe ajo e shkollës ku ka fëmijën për kohën më të madhe të ditës. Nga ana tjetër, këto nisma të reja kërkohen që dyert e shkollave të mbeten të hapura deri në pasditët e vona. Psikologët e shkollave tashmë të kudogjendur, edhe në shkollat e katundeve më të thella, ku plotësohen kriteret, duhet të jenë "më miqësorë" dhe leva të vërteta lëvizëse në këtë drejtim. Kjo do të bëjë që prindërit "t'iu bjerë rruga" më shpesh nga shkolla, çdo ditë, se sa nga kisha dhe xhamia, një herë në javë.

Nga Gjergj Meta

Kronika e emisionit investigativ "Le Iene" të Mediaset-it, rreth fëmijëve që mbledhin krom në Bulqizë, e shtoi edhe më shumë atë ndjesi negative, që shpesh na kaplon kur shohim se në vendin tonë ende shumë gjëra janë duke ecur mbrapsht. Shumë punë bëhet për fëmijët nga shumë organizma qeveritarë dhe jo qeveritarë, por ka një kujdes të vogël ose aspak kujdes për fëmijët dhe adoleshentët e periferive. Duhet të ndodhë ndonjë kronikë e ndonjë tv të huaj, apo ndonjë aksident si ajo e Ardit Gjoklajt në periferitë e Tiranës, i cili punonte te plehrat, që të zgjohen antenat tona reaguese.

Është e pa tolerueshme që në zemër të Europës të shihen ato pamje. Unë e di situatën e shumë familjeve në zonën e Mirditës, Bulqizës, Burrelit e me radhë, pasi jam ipeshkvi i zonës, por konstatiimi nuk mjafton. Pamjet e atyre fëmijëve janë të pajustificueshme dhe, si thotë një shprehje biblike, →

Opinion i Ditës

Nga Jorida Tabaku

(Vijon nga faqja e parë)

"Buxheti 2018", 48 milionë euro taksa shtesë për qytetarët e bizneset

... Fatkeqësisht, ajo çfarë na është paraqitur sot në komision është vazhdimi i një politike të gabuar që vazhdon të ngulë gishtin në plagën e hapur në vitin 2014. Vazhdohet të thellohet akoma më tej problemi i borxhit, problemi i shpenzimeve dhe, gjithashtu, problemi i politikave fiskale.

Së pari, dua të sqaroj se Partia Demokratike në rastin e miratimit të projektligjit të ofruar për TVSH-në, i cili kërkon t'i japë një të drejtë antikushtetuese qeverisë për të ndryshuar pragun e TVSH-së me VKM, do ta dërgojë këtë paketë në Gjykatën Kushtetuese. Arsyetimi është i thjeshtë, neni 155 i Kushtetutës i jep tagrin vetëm institucionit legjislativ, pra parlamentit, që të vendosë taksat, tatumet dhe detyrimet financiare kombëtare e vendore, lehtësimin ose përjashtimin prej tyre të kategorive të caktuara të paguesve. Projektligji që ka propozuar qeveria do që këtë funksion që Kushtetuta ia jep parlamentit t'ia kalojë qeverisë, që kjo e fundit të marrë edhe funksionet e institucionit parlamentar përmes një VKM-je.

Së dyti, kjo paketë fiskale do të marrë nga xhepat e qytetarëve dhe nga arkat e bizneseve të vogla, dhe ato që nuk janë pjesë e oborrit qeveritar 48 mln USD taksa dhe tatumet. Nën moton e rilindur "Të bëjmë propagandë se populli do t'i paguajë taksat tona", qeveria vazhdon të sjellë në Kuvend taksa që rëndojnë edhe më shumë xhepat e qytetarëve dhe bizneseve.

Së treti, qeveria parashikon rritje të taksave, por jo miradmirimin e kësaj rritje, akoma më qartë: qytetarë do t'i paguani taksat e larta, por qeveria nuk është e sigurt nëse paratë do të shkojnë në arken e shtetit apo në xhepin e ndokujt!

Së katërti, qeveria vazhdon të na mbajë në errësirë për vlerën që do të kenë në buxhet dhe mbi të

Amerikane e Tregtisë këmbëngulin që kjo politikë të mos kryhet, sepse do të sjellë më shumë probleme për BV.

Propozimi i qeverisë për të vendosur TVSH-në 6% për të gjitha shërbimet e hoteleve me 4 dhe 5 yje (kategorizim që qeveria do t'ia vendosë vetë atyre), përjashtimi i këtyre hoteleve nga taksa e ndërtimit dhe për dhjetë vjet nga tatimfitimi është pabarazia më e madhe që qeveria bën në kurriz të biznesit dhe në favor të oligarkëve.

Vendosja e taksës së pronës

duke ndryshuar mënyrën e llogaritjes që për rrjedhojë do të sjellë edhe rritjen e saj, është një kosto e shtuar në kurriz të qytetarëve. Një pensionist që ka një shtëpi të periudhës komuniste apo një shtëpi të vjetër tiranase do t'i duhet të paguajë për 100 metër katror 5.000 lek taksë për pronën.

Qeveria kështu i kërkon një pensionisti të paguajë 2.000 lekë më shumë taksë mbi pronën, por përmes një statusi të veçantë i dhuron një biznesmeni pranë saj shansin që të mos paguajë taksën



gjitha në deficitin buxhetor, koncesionet dhe projekti 1 mld euro që ka premtuar të implementojë në vitin 2018.

Më konkretisht Në lidhje me paketën fiskale dhe veçanërisht taksat e reja të vendosura në të; dua të ritheksoj qëndrimin kundër të PD-së sa i takon tentativës së fshehur të

qeverisë për uljen e pragut të TVSH-së në 2 mln lekë. Një lëvizje e tillë rëndon xhepat e konsumatorëve dhe fut në një skemë të ngatërruar bizneset e vogla, duke i ngarkuar ato me një taksë të re të fshehur. Kjo lëvizje është një përpjekje që të fshehtë problemën real të evazionit fiskal, biznesin e madh. Jo më kot, FMN dhe Dhoma

e ndikimit mbi infrastrukturë.

Po kështu, qeveria i kërkon Kuvendit që t'i japë të drejtën antikushtetuese asaj për të caktuar si t'i teket pragun e TVSH-së. E mbi të gjitha, nesër do të përfshijë në zinxhirin e TVSH-së një biznes të vogël, ndërkohë që do ta përjashtojë nga tatimi mbi fitimin si dhe do t'i dhurojë një TVSH me 6% biznesmenëve të veçantë.

Qeveria në projektbuxhetin që na ka servitur i rikthehet avazit të mos-rritjes së pagave. Një vit më parë shpenzimet për pagat u rritën 55 mln USD, edhe vjet me ngritjen shqetësimin se kjo vlerë është më e ulët, qeveria këtë vit parashikon të shpenzojë për pagat 10 mln USD. Pra, 45 mln USD më pak për shpenzime të mira e të këqija. Dorëzohuni përpara faktëve: zemra ju rreh fortë për një pension të veçantë, që deri më tani e keni shpërfilur!

Ish -të përndjekurit politikë vazhdojnë të jenë grupi i harruar i qeverisë, ato vazhdojnë të marrin një vlerë prej 20 mln USD, një vlerë, e cila edhe sipas raportit të KLSH është e pamjaftueshme dhe e zhvlerësuar detyrimisht që shteti jonë ka karshi tyre. Sipas logarive të KLSH, me këto hapa do të duhen rreth 16 vjet për ta shlyer vetëm detyrimin monetar karshi tyre. KLSH, gjithashtu, rithekson të shqetësimin e ngritur nga ne, se qeveria nuk po shlyen më shumë detyrime ndaj ish -të përndjekurve, në të kundërt ajo vazhdon sorollatjen e tyre.

Rriten shpenzimet e qeverisë për rikonstrukcione zyrrash, pajisje zyrrash dhe makinash. Sipas një logarie të thjeshtë me 18.4 mln USD që qeveria mund të kishte kursyer në këtë zë luksi, mundet të sigurohej 2 vjet e gjysmë pagesë papunësie, 92% e fondit vjetor për pagesat e ish-të përndjekurve politikë dhe rritja e pagave.

Autorja, deputete e Partisë Demokratike

Horoskopi section with sub-headers: DASHI, DEMI, BINJAKET, GAFORJA, LUANI, VIRGJERESHA, PESHORJA, AKREPI, SHIGJETARI, BRICJAPI, UJORI, PESHQIT. Each section contains a small horoscope text.

Fëmijët e periferive klithin në heshtje

thërrasin hakmarrje përpara Zotit. Nuk mund të qëndrojmë indiferentë, ndryshe do të jemi bashkëfajtorë. Më së pari shteti me ministrinë përkatëse, Ministrinë e Arsimit dhe asaj të Punës e pse jo edhe me Tatimet e policinë për të parë veprimtarinë e grostëve të kromit e të prodhimeve të tjera e, po ashtu, edhe në të tjerët, mediat dhe OJQ-të, organizmat fetare dhe jo fetare që kanë sadopak për zemër këtë vend.

Në këtë mënyrë po u vjedhim të ardhmen atyre fëmijëve. Nuk u lejojmë të jetojnë bukurinë e lojës dhe të moshës së tyre. Ua mohojmë ditën për diell, me indiferencën tonë dhe me pafuqinë e një shteti për t'i dhënë fund kësaj skamje e për të kontrolluar shfrytëzimin e të miturve. Diku kromi e diku lëndët narkotike, po traumatizojnë një brez fëmijësh dhe të rinjsh që do të jetë i plagosur në të ardhmen. Pamjet e përcjella nga Mediaset-i edhe njëherë na vënë përpara



përgjegjësisë të gjithë neve. Nuk mund të fshihemi e nuk mund të drejtojmë gishtin vetëm në njerëz anë. Duhet të gjithë bashkë, të ulim, e përsëris, të ulim e të dorëzojmë armët e retorikës konfliktuale që nuk po çon asgjëkundi e të shkojmë drejt një aliance për të mirën e ven-

dit dhe të fëmijëve që janë e ardhmja e vendit. Duhet tani dhe urgjentisht, të gjithë bashkë, pa humbur kohë.

Këto probleme si varfëria dhe korrupsioni janë problemet e vërteta të vendit tonë, sepse aty luhet dinjiteti i genieve njerëzore, i çdo banori të Shqipërisë. Nuk mund të lejojmë që pasurimi i pak vetëve të dëmtojë jetën e shumicës së njerëzve. Jo! Nuk është e mundur kjo gjë.

Unë si bari i kësaj zone, nuk mund ta hesht realitetin e trishtë që pashë e që shoh shpesh kur vizitoj zonat e sipërpërmendura. Mudohehmi të bëjmë shumë punë me fëmijët pas shkolle duke indihmuar me anë të motrave dhe mësuesve vullnetarë që të rikuperojmë mësimet, sidomos me fëmijët e varfër. Kështu bëjmë në Rrëshen e në Burrel e nganjëherë duke hasur edhe vësh-tirësi nga jashtë. Nuk kemi asnjë in-

teres fetar, por vetëm atë të fëmijëve e adoleshentëve që të kenë një të ardhme sa më të mirë.

Ndoshta edhe kjo video që pamë e të tjera shumë do të harrohen në krye të tri ditëve, pasi të bëjnë pak zhurmë, ose nuk bëjnë zhurmë aspak, duke qenë korja mediatike, është aq e fortë sa që vështirë të përshkohet nga këto pamje. Megjithatë ne jemi këtu dhe nuk do ta ulim zërin sa herë që të jetë e nevojshme dhe jemi të gatshëm, me gjithë mundësitë tona, që të bashkëpunojmë për të mirën e fëmijëve dhe të ardhmës së vendit tonë.

Sidomos do të ngremë zërin nga, dhe për periferitë e vendit, ato të harruarat nga shteti, OJQ, por jo nga Zoti, i cili nëpërmjet shumë njerëzve kujdeset. Nuk mund të harrohen fëmijët vetëm pse jetojnë në Bulqizë, a në Kurbnesh, në Pukë apo në Dibër e Burrel, në Mirditë apo në Tropojë e Kukës. Periferitë duhet të jenë në qendër, pasi nuk janë tepër.



E konfirmon zëdhënësja Obradović 98 kamera sigurie dhe 2 tribuna të mbyllura, serbët blindojnë stadiumin

Në një intervistë për "Su persport", zëdhënësja për shtyp e klubit të Partizanit, Biljana Obradović, ka deklaruar të gjitha masat që klubi serb ka marrë për të siguruar një mbarëvajtje normale të ndeshjes me Skënderbeun. Për të evituar skenat që ndodhën 14 tetorin e 2014, me Kombëtaren shqiptare, ajo u shpreh se këto janë masat më ekstreme që klubi i Partizanit ka marrë ndonjëherë. "Tuneli nga ku do dalin lojtarët do të zgjatet deri tek fusha e lojës, për të ndaluar sendet e forta. Tribuna voriore dhe një pjesë e tribunës lindore do të jenë të mbyllura për tifozët, dhe do t'u shërbejnë vetëm forcave të policisë", - deklaroi Obradović. Më tej, për masat e marra për tifozët, ajo tha: "Biletat do të jenë me emër dhe mbiemër. Ata që do vijnë në stadium duhet të kenë një mjet identifikimi me vete. Spektatorëve nuk do t'u

lejohej asgjë tjetër përveç sendeve personale, si telefona e çelësa. Stadiumi do mbulohet nga 98 kamera sigurie". Biljana kërkon që ndeshja e së enjtes të jetë e përkryer, ashtu siç ajo vlerësoi ndeshjen e parë, të zhvilluar në Elbasan. "Dua të falënderoj shqiptarët për mikpritjen që na dhanë në Tiranë e Elbasan. Siç e tha dhe trajneri Dukiq, presim një sjellje korrekte prej tifozëve tanë, të respektojmë shqiptarët ashtu siç na respektuan neve", - përfundoi Obradović.

lejohej asgjë tjetër përveç sendeve personale, si telefona e çelësa. Stadiumi do mbulohet nga 98 kamera sigurie". Biljana kërkon që ndeshja e së enjtes të jetë e përkryer, ashtu siç ajo vlerësoi ndeshjen e parë, të zhvilluar në Elbasan. "Dua të falënderoj shqiptarët për mikpritjen që na dhanë në Tiranë e Elbasan. Siç e tha dhe trajneri Dukiq, presim një sjellje korrekte prej tifozëve tanë, të respektojmë shqiptarët ashtu siç na respektuan neve", - përfundoi Obradović.

Trajneri i korçarëve ka gati planin anti-Partizan. Shpresat, te Gavazaj e Soue



Jeton Selimi

Ilir Daja: Duam fitoren, uroj të mos kemi probleme Skënderbeu synon pikë në Beograd

Në intervistën para ndeshjes me Partizanin e Beogradit, trajneri Daja u shpreh se e di mirë se Partizani është më ekspert në këto kompeticione, por ai ka besim se mund të marrë një rezultat pozitiv nga Beogradi.

Si e shihni përballjen me kundërshtarin?

Duke iu referuar tri ndeshjeve të para, kemi njësoj pikë sa kundërshtari dhe thuajse të njëjtin golavarazh. Nisur nga ndeshja e fundit në Elbasan, pavarësisht vlerave, vumë re që nuk ishim inferior nga ai. E dimë që është shumë e vështirë, por do të futemi për rezultat pozitiv në Beograd.

Si mendoni se do të ndikojë prania e tifozërisë serbe?

Duke pasur mbështetjen e tifozëve të tyre, ata do të kërkojnë që patjetër ta fitojnë. Kjo bën që nga njëra anë t'iu shtohet doza e motivimit, por ana tjetër e medaljes është që ngarkesa kalon tek ekipi kundërshtar. Ekipi që kërkon patjetër fitoren, ka ngarkesë emocionale. Duhet të jemi të kujdesshëm. Të bëjmë lojën tonë që kemi bërë edhe në kualifikuese, apo edhe në tri ndeshjet e para. Kemi njohje për ekipin kundërshtar. Është



të e vështirë, por nuk mendoj se është e pamundur që të menaxhojmë drejt emocionet.

Si do të luajë Skënderbeu në raport me ndeshjen e fundit?

Pa hyrë në detaje taktike, sepse sigurisht që janë pjesë të punës që nuk mund të prezantohen para ndeshjes. Përshtatja e ekipit kundërshtar me ambientin është më e madhe, sepse luajnë në

shtëpinë e tyre. Ndaj, ata do të kërkojnë që të jenë më agresivë, nëse mund ta them në aspektin sportiv. Uroj që të kemi zgjedhur elementet e duhur që të përballojmë presionin, që kundërshtari do ta shfrytëzojë në këtë ndeshje duke qenë se është

përballë publikut të tij.

Si është gjendja e skuadrës, a keni lojtarë në dyshim?

Kemi lojtarë që vijnë nga dëmtimi dhe që nuk kanë gjendje optimale. Kjo është diçka që i trembemi. Referuar dy ndeshjeve të fundit,

kemi bërë ndërrime të detyruara që në fillim dhe kjo bën që menaxhimi i pjesës tjetër të ndeshjes, kërkon shumë më tepër kujdes. Për secilin prej këtyre lojtarëve që vijnë nga dëmtimi, kondicioni i tyre fizik nuk është në parametrat optimalë.

Ngjarjet e të shkuarës, mendoni se do të ndikojnë?

Do të fokusohemi tek aspekti sportiv, sepse kemi ardhur në Beograd për të fituar ndeshje futbollit dhe jo diçka tjetër. Shpresoj që të na kthejnë atë lloj qetësie që i kemi dhënë secilit kundërshtar në Elbasan. Uroj që të flasë vetëm futbollit. Do të fokusohemi vetëm te ky aspekt, pasi pjesët e tjera nuk janë në të mirë as të ekipit tonë dhe as të kundërshtarit.

Vështirësi për të bërë zgjedhje dhe sa besoni se

Soue dhe Gavazaj do të jenë vendimtarë?

Pothuajse i gjithë kontingjenti është në dispozicion, për herë të parë. Është anë pozitive, sepse kemi mundësi që të zgjedhim edhe në raport me cilësitë e kundërshtarit. Pavarësisht kësaj, ardhja nga dëmtimet, kondicioni i tyre nuk është maksimali. Mendoj se do të startojmë mirë, duke shpresuar që të mos na ndodhin probleme gjatë ecurisë së ndeshjes.

Gavazaj dhe Soue?

Besoj se deri në këto momente kemi bërë lojë në grup në të dyja fazat. Nëse duam suport nga pjesa tjetër, edhe këto dy duhet të jenë aktiv në fazën mbrojtëse për të mos na krijuar superioritetin numerik në zonën tonë.

Do guxonin që të arrinin fitore, ashtu si 30 vite më parë një ekip shqiptar u kualifikua në Beograd?

Po përgjigjem unë, meqë për të bërë krahasimin duhen disa faktorë edhe për faktin se Mici ka qenë... në projekt (qesh...). Ka qenë përballje e vështirë edhe në atë kohë. Nuk ka ngjashmëri, pasi dinamika prej 30 vjetësh i bën të ndryshëm të dyja ekipet. Shpresoj që të na ndjekë ajo pjesë e fatit. Pse jo ta përsëritim. Ne jemi të ndërgjegjshëm dhe ndeshja është shumë e vështirë, edhe për meritave të kundërshtarit që është me gjithë mend shumë i fortë, sidomos në fushën e tij.

MASAT

Mediat serbe: Ndalohen 3 shqiptarë me dron

Siç raportojnë mediat serbe, policia vendëse ka ndaluar 3 shtetas shqiptarë në Preshevë, të cilët po udhëtonin drejt Beogradit. Pas kontrollit në makinën e tyre, policia ka gjetur edhe një dron brenda. Duke marrë shumë i kanë lejuar shqiptarët të vazhdojnë për në kryeqytetin e Serbisë. E gjithë kjo bujë vjen edhe pas rastit të 14 tetorit, para 3 viteve, kur Ballist Morina uli dronin në stadiumin e Partizanit, gjatë ndeshjes Serbi-Shqipëri.



MBROJTËSI

Mici: Kemi ardhur për të luajtur futboll

I pranishëm në konferencën për shtyp para ndeshjes me Partizanin e Beogradit, bashkë me trajnerin Ilir Daja ishte edhe mbrojtësi Gledi Mici. Ai u shpreh se ekipi ka ardhur në Beograd vetëm për futboll dhe asgjë më shumë. Korçarët duket se e kanë analizuar mirë kundërshtarin dhe do të provojnë të marrin maksimumin nga kjo sfidë. "Atmosfera është mjaft e mirë. Kemi përgatitur si ndeshje të radhës dhe pa shumë presion. Është ndeshje shumë e vështirë, por do të japim maksimumin për të marrë, pse jo edhe tri pikët. Mendoj se në minutat e fundit nuk pati ndonjë gjë serioze. Është vetëm pjesë e lojës, kur lodhja ndikon dhe kërkohet ndonjë kujdes më i madh. Jemi përgatitur të gjithë që ta kemi mendjen te futbollit, të jemi të përqendruar, sepse është kundërshtar cilësor, që mund të na ndëshkojë pas çdo gabimi.




THIRRJA

Stojkoviç, apel tifozëve serbë: Mos i fyeni shqiptarët, atje na pritën si miq

Portieri i Partizanit të Beogradit, Vladimir Stojkoviç, ka dalë dje para mediave enkas për t'u bërë apel tifozëve, veçanërisht grupimit të njohur "Grobari". Sipas portierit, nesër tifozët nuk duhet të bëjnë asnjë thirrje kundër shqiptarëve. "Mesazhi është i qartë: ne duhet të organizojmë mbi të gjitha një ndeshje sa më normale. Duhet të vlerësojmë se si shqiptarët sillleshin ndaj nesh në ndeshjen që luajtëm dy javë më parë. Ne nuk kemi përjetuar asnjë moment të pakëndshëm në Shqipëri. Unë do t'u kërkoj të gjithë tifozëve të mbushin stadiumin dhe të mbështesin ekipin brenda normave. Nuk ka pse të na lëndoni, sepse Partizani është mbi të gjitha. Çdo mosbindje do të dënohet nga UEFA. Duhet të gëzohejmë të gjithë bashkë për fitoren, por tifozët të jenë të përmbytur. Nuk kanë punë me kundërshtarin. Jemi nën vëzhgim për këtë takim dhe rrezikojmë shumë", theksoi portieri serb.



Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Emri i Monet.
- Një top në rrjetë.
- Carl Edward, që shkroi Contact.
- Qe bukurishi që u hidhte ferë perëndive.
- Qe era hynore e japonezëve.
- Një pjesë e lartësive.
- Muzikanti që... nuk përsërishte.
- Lumë në Rusi.
- Eshhtë i lartë ai i kampionit.
- Kalifi që themeloi Kairon.
- Kështu e quajti Krishti shën Pjetrin.
- Janë në guvë.
- Ilioni portier.
- Markë makine.
- Ashtu si duhet të përgjigjet fituesi.
- Inicialet e Mann.
- Një parabolë e tenistit.
- Fillojne tatepjeten.
- Ente Autonome.
33. Jean, që solli duhanin në Europë.

VERTIKAL

- Inicialet e Santana-s, kitarist.
- Nota e diapazonit.
- Eshhtë frika nga shehet e hapura.
- Diftong në duar.
- Duhen në ekstreme.
- Qe libri erotik i Mallanaga Yatsuyana-s.
- Lauda ish-pilot i Formula 1.
- Janë lotët që gjithkush i derdh me kënaqësi.
- Një poemë.
- Fund tuneli.
- Një eleganat si Aramis.
- Qe kryeqyteti i Asirisë.
- Qe toreador i famshëm.
- Urdhëroi sakrifikimin e Ifigenias.
- Eshhtë pushteti i... bashkisë.
- Qe lumi i Karontit.
- Inicialet e Klee piktor.
- Ishte gjuha e Jezu Krishtit.
- U shndërrua në dre nga Afërdita.
- Rex i Nero Wolfe.
- Nino, kompozitor i njohur.
- Një... story e John Le Carré.
- Shkroi Tregime të sjtëzakonshme.
- Kufizojnë një sektor.
- Inicialet e Einstein.
- Inicialet e Mattheu, këngëtare.
- Kufizojnë sportet.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Lindi Isakun.
- Në krye të bashkisë.
- Në djep kur nuk... je.
- Nota e diapazonit.
- Emri i parë i Erasmit të Rotterdemit.
- Mbyllin akte.
- Filozofi i famshëm me historine e gomarit.
- Diku në qendër.
- Rrallë është përgjysmë.
- Bëri edhe Madame Butterfly.
- Norman, psikopati te Psycho.
- Të parat në sjellje.
- Vret me një re.
- Gjarpri që u vra nga Apolloni.
- Lindi Perseun.
- Besniku mesfushor.
- Ai i vajimit është në Jerusalem.
- Carol, aktore.
- Në krye të subjekteve.

VERTIKAL


- Ishte sundimtari i provincave perseisha.
- Inicialet e Duvall.
- Cyetei i njembjndëritarve.
- Ishte armiqetëe bablonasve.
- Shkroi Jacuqës le fataliste.
- Eshhtë edhe tendencë.
- Joan i interpretuar nga Celentano.
- Jetonë në vetmi.
- U solli në Europë në Jean Nicot.
- Ai i Aida-s është Radames.
- Një ishte edhe Deceball.
- Inicialet e Rohmer regjisor.
- Titulli i Bruce Springsteen.
- Hidhet një me... kercim.
- U shkrua nga Camus.
- Fillojnë takimin.
- Fillojnë natën.
- Pierce teniste.
- Grisur pa gur.
- Fillojnë panikun.
- Shijuar pa shuar.
- Fleming, që krijoi James Bond.
- Kështu merr ai që... mbaron.
- Mbajtësja e topit në golf.
- Ekstreme për gotik.
- Carson i funnneti-t.
- Një padë kur s'është ai.
- Bëhen arianë me një anë.
- Harris që krijoi Hannibal Lecter (inic).
- Bëhet nuse me ne.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

	7	2		6	9	1			
6				2		8	5		
5	9	3	4						
			2	7				3	
1	6						7	8	
3				8	6				
					1	5	9	7	
	4	1		5				2	
		8	3	9		4	6		

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

7	5	9	3	6	4	1	2	8	
2	8	3	1	7	9	5	6	4	
6	1	4	2	8	5	7	3	9	
8	6	2	7	4	1	9	5	3	
9	3	7	8	5	2	6	4	1	
5	4	1	9	3	6	8	7	2	
4	9	8	6	2	7	3	1	5	
1	7	5	4	9	3	2	8	6	
3	2	6	5	1	8	4	9	7	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Ambicja mund të zvarritet, por mund të ngrihet edhe në fluturim. (Edmund Burke)
- Më e mira është armike e së mirës. (Volter)
- Megjithëse bota është plot vuajtje, ajo është gjithashtu plot me shembuj për kapërcimin e tyre. (Helen Keller)
- Besimi lëviz malet, por ju duhet të vazhdoni t'i shtyni ato, ndërkohë që kryeni lutjen. (Meson Kulej)

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

5	K	1	A	12	F	3	E		2	1	6	3	10	2
1	9	1	8		11	1	12		2	3	7			
3	2	2		13	3	11	1	2	4	2	4			
3	2		13	3	7	3	2	4	5	3				
15		5	9	8	4	2	3	2	3	2				
9	3	5	4	11	3	2		2			12			
7	4	5	10	3	2		2	1	11	1				
4	9		15	16				17	2	4	6			
5	1		17	20	4	10	15			17	6			
3	9		11	1	2	3	10	2	1	2				
	10	1		19	3			18	7	1	2			
1	19	8	4			11	4	7	1	2	4			

S	T	R	I	P	B	B	V	O	T	A
H	E	R	O	I	N	A	O	V	E	R
S	A	S	S	N	R	V	R	T		
U	T	S	H	T	E	T	E	R	O	R
B	L	I	T	E	R	A	T	U	R	A
M	I	N	E	R	A	L	E	T	C	
K	A	L	O	R	E	S	I	T	H	A
C	A	R	I	S	T	I	N	T	L	
V	H	I	M	I	M	I	K	E		
R	A	M	E	T	N	A	A	R		
A	D	R	E	S	E	I	T	A	L	I
P	O	L	E	M	I	K	A	S	E	A

Thënie të mëçuara

- Mirënjohja është një barrë, dhe çdo barrë është bërë për t'u çliruar prej saj. **Denis Diderot**
- Nuk ka asgjë në botë që të çarmatosë më shumë e më fort sesa mendimi që përmban mirësi...
- Nga mënyra e të qeshurit unë kuptoj se çfarë edukate ka një njeri, ndërsa nga arsyeja e të qeshurit kuptoj inteligjencën e tij. **Rumi**
- Vlera e një njeriu duhet parë në faktin se çfarë jep, dhe jo në atë se çfarë është në gjendje të marrë. **(Albert Anjstajni)**
- Eshhtë më mirë t'i meritoni nderet dhe të mos i gëzoni ato, se sa t'i gëzoni dhe të mos i meritoni. **(Mark Tueni)**

PËRGJIGJET E FJALËKRYQVE TË NUMRIT TË KALUAR

M	A	T	A		H	E	L	M	E	T
A	R	R	V	E	D	D	E	P	P	P
P	A	R	A	L	E	L	E	T	L	E
	P	O	L	I	F	E	M	I	O	L
E	M	I	L	E	Z	O	L	A	E	T
L	A	I	R	A	E	R	R	E	Z	E
E	R	A	I	B	E	M	R	I	I	S
H	I	M	A	E	S	T	R	O	D	E
T	A	L	E	N	T	E	T	A	R	E
E	S	I	K	R	A	H	O	R	A	R
K	A	P	A	N	O	N	E	T	L	A
D	L	S	K	O	T	E	K	A	T	A
R	O	M	A	N	A	R	G	O	S	A
E	N	T	G	N	I	R	H	R	E	
W	M	O	N	O	G	R	A	F	I	A
P	O	L	E	G	R	I	N	A	Z	H
P	O	L	I	G	L	O	T	E	T	I
A	L	K	R	A	H	E	T	K	S	H
K	E	N	I	T	T	K	A	S	T	E
E	M	I	L	E	N	J	O	M	E	R
T	I	M	E	R	S	T	A	N	E	T
A	K	S	E	R	I	O	Z	R	A	M
T	E	O	T	R	A	Z	J	A	R	I

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE



Tashmë edhe lundroni!

